NDËRMARRJA PUBLIKE-PUBLIC ENTERPRISE-JAVNO PREDUZEĆE
TERMOKOS SH.A. J.S.C. D.D.
PRISHTINË-PRISHTINA-PRIŠTINA
Nr 1938 Dt. 11.10 2024

Termokos
Ngrohtorja e qytetit

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 5691/24
Data. 11.10.2024

| | |
|---|---|
| Për : | Zyrën e Rregullatorit të Energjisë |
| Nga: | Valdete Mareveci-Dërmaku - Koordiantore e Ndërmarrjes me Institucione Tjera |
| Përmes: | Fisnik Osmani – Kryeshef Ekzekutiv i NP"Temokos"SH.A-Prishtinë |
| Data: | 11.10.2024 |
| Subjekti : | **Raportimi Rregullativ i N.P "Termokos"Sh.A. në kuadër të Aplikimit për shqyrtim të tarifave për sezonin e ngrohjes 2024/2025** |

Në lidhje me shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2024/2025, ju përcjellim të bashkangjitura këto raporte:

1. Pasqyrat Rregullative me të dhënat e parashikuara për periudhën (15 tetor 2024 – 15 tetor 2025),

2. Shpalosja e Pasqyrës B,

3. Raportet e detajuara, në kuadër të aplikimit për shqyrtimin tarifor për sezonin ngrohës 2024/2025, të cilat përmbajnë:

   a. Planifikimi i prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B dhe në ngrohtoren qëndrore të NP "Termokos"SH.A,
   b. Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë ,
   c. Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve,
   d. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik ,
   e. Planifikimi i kyçjeve të reja,
   f. Planifikimi i investimeve me vetfinancim dhe nga donacionet.

4. Përgjigjet e NP "Termokos" sh.a në komentet e dhëna nga ZRRE, në Aplikacionin për shqyrtimin e tarifave për sezonin 2024/2025,

5. Dokumetet plotësuese lidhur me sqarimet për projektin e KFW ( dërguar me e-mail me datë 22.08.2024):

   a) "Raportin e Progresit nr. 19" ,

   b) " Minutat e takimit - M2" ,

   c) "Minutat e takimit - M14" ,

   d)"Minutat e takimit - M15 ".

6. Raportin me përmbledhje të faturimeve për muajt Janar-Prill 2024 dhe Raportin për konsumin dhe faturimin e ndarë sipas nënstacioneve, për 5000 konsumatorë ( dërguar me e-mail me datë 11.09.2024).

NDËRMARRJA PUBLIKE-PUBLIC ENTERPRISE-JAVNO PREDUZEĆE
TERMOKOS SH.A. J.S.C. D.D.
PRISHTINË-PRISHTINA-PRIŠTINA
Nr 1938/1 Dt. 11.10 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 594/24
Data. 11.10.2024

# PASQYRAT (DEKLARATAT) RREGULLATIVE

**Planifikimet**
**/Sezoni 2024-2025/**

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

# Raportimi Rregullativ - Shqyrtimi i tarifave - Sezoni 2024-2025

Ndërmarrja: **NP"Termokos"Sh.a** Periudha: **15 tetor 2024 - 15 tetor 2025**

## *Pasqyra A - G1, G2 : Pasqyra e Aseteve Operative*

Në Euro

| | | Asetet Drejtëpërdrejt të Përcaktuara | | Asetet Mbështetëse | Asetet e përbashkëta | Totali I Asetve |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Prodhimi i ngrohjes | Distribuimi dhe furnizimi i ngrohjes | | | |
| | a | c | d | e | f | g |
| 1 | Çmimi I blerjes me koston historike | 28 239 624,00 | 44 096 405,00 | 3 829 944,85 | 3 129 274,62 | **79 295 248,47** |
| 2 | Zhvlerësimi I akumuluar | 15 345 644,00 | 13 617 988,86 | 398 714,80 | 282 679,32 | **29 645 026,98** |
| 3 | Vlera sipas librave kontabël | 12 893 980,00 | 30 478 416,14 | 3 431 230,05 | 2 846 595,30 | **49 650 221,49** |
| 4 | Çmimi zavendësues në vleren e tregut | | | | | **0,00** |

| Aprovuar nga: | Punuar nga: |
|---|---|
| EMËRI, MBIEMËRI/Pozita | EMËRI, MBIEMËRI/Pozita |
| Arton Shabani | Luljeta Muqolli |
| ZKFTH | Udhëhëqse e Kontabilitetit |
| Nënshkrimi: | Nënshkrimi: |
| Data:22.08.2024 | Data:22.08.2024 |

NDËRMARRJA PUBLIKE - PUBLIC ENTERPRISE SHA-J.S.C.-D.D. Termokos PRISHTINË

ЈАВНО ПРЕДУЗЕЋЕ „ЕЛЕКТРОСРБИЈА" – ЛОЗНИЦА
ЕЛЕКТРОСРБИЈА
Институт за високонапонску технику и заштиту од електромагнетских утицаја
Институт

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

# Raportimi Rregullativ - Shqyrtimi i tarifave - Sezoni 2024-2025

Ndërmarrja: **NP"Termokos"Sh.a** Periudha: **15 tetor 2024 - 15 tetor 2025**

## *Pasqyra B - G1, G2 : Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve*

Në Euro

| | | Drejtpërdrejt të Përcaktuara | | Mbështetëse | Të Përbashkëta | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Prodhimi I Ngrohjes | Distribuimi dhe Furnizimi i ngrohjes | | | |
| | a | c | d | e | f | g |
| 1 | **Të Ardhurat e lejuara** | | | | | |
| 2 | Të ardhurat nga shitja e ngrohjes | | 10 080 698,29 | | | **10 080 698,29** |
| 3 | Të ardhurat tjera të lejuara | | 105 000,00 | | | **105 000,00** |
| **4** | **Totali i të ardhurave të lejuara** | | | | **0,00** | **10 185 698,29** |
| 5 | **Shpenzimet e lejuara** | | | | | |
| 6 | Shpenzimet Operacionale | | | | | |
| | Shpenzimet variabile : | | | | | |
| 7 | Energjia termike nga kogjenerimi | | | | 1 744 352,40 | **1 744 352,40** |
| 8 | Karburanti | | | | 0,00 | **0,00** |
| 9 | Uji I trajtuar | | | | 64 000,00 | **64 000,00** |
| 10 | Kemikalet për trajtimin e ujit | | | | 39 460,50 | **39 460,50** |
| 11 | Elektriciteti | | | | 814 200,00 | **814 200,00** |
| 12 | Shpenzimet e Personelit (puna direkte ne prodhim) | | | | 1 649 369,86 | **1 649 369,86** |
| 13 | Shpenzimet tjera variabile | | | | 930 216,50 | **930 216,50** |
| 14 | Totali i shpenzimeve variabile | | | | 5 241 599,26 | 5 241 599,26 |
| 15 | Shpenzimet fikse | | | | | |
| 16 | Riparimet dhe mirëmbajtja | | | | 108 150,00 | **108 150,00** |
| 17 | Materialet dhe shërbimet | | | | 100 000,00 | **100 000,00** |
| 18 | Shpenzimet për administratë | | | | 149 600,00 | **149 600,00** |
| 19 | Shpenzimet e personelit | | | | 1 885 287,69 | **1 885 287,69** |
| 20 | Shpenzimet e Shitjes dhe tjera Administrative | | | | 475 110,00 | **475 110,00** |
| 21 | Totali i shpenzimeve fikse | | | | 2 718 147,69 | 2 718 147,69 |
| 22 | Totali i shpenzimeve operative | | | | | |
| 23 | Zhvlerësimi | | | | 3 288 850,00 | **3 288 850,00** |
| **24** | **Totali I Shpenzimeve të Lejuara** | | | | **11 248 596,95** | 11 248 596,95 |

| Aprovuar nga: | Punuar nga: |
|---|---|
| EMËRI, MBIEMËRI/Pozita | EMËRI, MBIEMËRI/Pozita |
| Arton Shabani | Luljeta Muqolli |
| ZKFTH | Udhëheqëse e Kontabilitetit |
| Nënshkrimi: | Nënshkrimi: |
| Data:22.08.2024 | Data:22.08.2024 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

# Raportimi Rregullativ - Shqyrtimi tarifave - Sezoni 2024/2025

Ndërmarrja **NP"Termokos"Sh.a** Periudha: **15.10.2024-15.04.2025**

## *Pasqyra C-G2 : Pasqyra e Faturimit dhe Arkëtimit të Pagesave*

**Faturimi me matje - sipas konsumit të matur**

| | Sip. Ngrohëse [m2] | Kapac. Termik [kW] | Kons. i En. Term. [MWh] | Faturimi për kapac. [EUR] | Faturimi për energji [EURO] | Total faturimi [EURO] | Arkëtimi [EURO] | Arkëtimi [%] | Borxhi [EURO] | Borxhi [%] |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 546 937,36 | 602 684,06 | 63 879,36 | 470 093,57 | 2 315 626,62 | 2 785 720,19 | 2 550 000,00 | 91,54 | 235 720,19 | 8,46 |

**Faturimi pa matje - sipas sipërfaqjes ngrohëse**

| | Grupi i konsumatorëve | Sipërfaqja Ngrohëse [m2] | Faturuar [Euro] | Arkëtuar [Euro] | Shkalla e Arkët. [%] | Borgji [Euro] | Borgji [%] |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Shtëpijak (Amvisri) | 1 419 800,07 | 6 150 573,90 | 4 850 000,00 | 78,85 | 1 300 573,90 | 21,15 |
| 3 | Komercial dhe Institucional | 211 339,65 | 1 144 404,20 | 850 000,00 | 74,27 | 294 404,20 | 25,73 |
| 4 | **Total** | **1 631 139,72** | **7 294 978,10** | **5 700 000,00** | **78,14** | **1 594 978,10** | **21,86** |
| | | | | | | | |
| 5 | **Total (me matje + pa matje) [EURO]** | **2 178 077,08** | **10 080 698,29** | **8 250 000,00** | **81,84** | **1 830 698,29** | **18,16** |

| Aprovuar nga: | Punuar nga: |
|---|---|
| EMËRI, MBIEMËRI/Pozita<br>Fisnik Osmani -Kryeshef Ekzekut | EMËRI, MBIEMËRI/Pozita<br>Raif Vitija - Drejtor i Furnizimit |
| Nënshkrimi:<br>Data:22.08.2024 | Nënshkrimi:<br>Data:22.08.2024 |

NDËRMARRJA PUBLIKE - SHËRBIMI I NGROHJES PRESHEVË Termokos Ngrohtorja e qytetit PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

# Raportimi Rregullativ - Shqyrtimi i tarifave - Sezoni 2024-2025

Ndërmarrja: **NP"Termokos"Sh.A** Periudha: 15 tetor 2024-15 tetor 2025

## *Pasqyra D-G1, G2-Pasqyra e shpenzimeve të investimit -aktuale dhe e planifikuar*

| | | Në euro | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Aktuale -viti 0 | Planifikuar - viti 1 | Planifikuar - viti 2 | Planifikuar - viti 3 | Planifikuar - viti 4 |
| | a | tetor 2024 - 15 tetor2025) | | 2026 | 2027 | 2028 |
| 1 | Prodhimi I ngrohjes | 431 000,00 | 350 000,00 | 352 000,00 | 358 000,00 | 365 000,00 |
| 2 | Distribuimi dhe furnizimi me ngrohje | 280 000,00 | 140 000,00 | 160 000,00 | 180 000,00 | 200 000,00 |
| 3 | Tjera -Administrata dhe departamentet tjera | 1 942 881,34 | 2 200 000,00 | 1 200 000,00 | 500 000,00 | 600 000,00 |
| 4 | Termokosi- Bashkfinancim për projektet | 2 607 432,68 | 8 000 000,00 | 10 000 000,00 | 12 000 000,00 | 14,000,000,00 |
| 5 | **Totali I investimeve me vetëfinancim** | **5 261 314,02** | **10 690 000,00** | **11 712 000,00** | **13 038 000,00** | **1 165 000,00** |
| 6 | Donacionet për projektin "Solar 4 Kosova II" | 12 244 000,00 | 22 000 000,00 | 45 000 000,00 | 50 000 000,00 | 60 000 000,00 |
| 7 | Donacionet për projektin per dyfishim te kapaciteteve prodhuese | 1 000 000,00 | | | | |
| 8 | **Total donacionet /euro** | **13 244 000,00** | | | | |
| 9 | **Grand Total /euro** | **18 505 314,02** | **32 690 000,00** | **56 712 000,00** | **63 038 000,00** | **61 165 000,00** |

| Aprovuar nga : | Pranuar nga: |
|---|---|
| EMËRI, MBIEMËRI/Pozita<br>Fisnik Osmani : Kryeshef Ekzekutiv<br>Nënshkrimi:<br>Data:22.08.2024 | EMËRI, MBIEMËRI/Pozita<br>Naim Bytyçi-Drejtor I Distribuimit<br>Nënshkrimi:<br>Florent Hoxha - Drejtor I Prodhimit<br>Nënshkrimi:<br>Data:22.08.2024 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

# Raportimi Rregullativ - Shqyrtim i tarifave - Sezoni 2024 / 2025

Ndërmarrja: **NP"Termokos"Sh.a**

Periudha: **15.10.2024-15.04.2025**

## *Pasqyra E - G1, G2 - Pasqyra Teknike*

| | Të dhënat e përgjithshme teknike | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Kapaciteti I instaluar i energjisë termike(ngrohjes) në ngrohtore | MW | 135,60 |
| 2* | Kapaciteti I instaluar i energjisë termike nga kogjenerimi | MW | 140,00 |
| 3 | Kapaciteti I disponueshëm I energjisë termike(ngrohjes) në ngrohtore | MW | 134,00 |
| 4* | Kapaciteti I disponueshëm I energjisë termike(ngrohjes) nga kogjenerimi | MW | 140,00 |
| 5* | Gjatësia e rrjetit të transportit të en.term.KEK-Termokos | km | 11,50 |
| 6 | Gjatësia e rrjetit të distribuimit | km | 109,00 |
| 7 | Numri I nënstacioneve | - | 901,00 |
| 8 | Numri I nënstacioneve aktive | - | 871,00 |

| | Bilanci i energjisë | | |
|---|---|---|---|
| 6 | Energjia e futur nga karburanti | MWh | **0,00** |
| 7 | Prodhimi bruto I ngrohjes në ngrohtore | MWh | 0,00 |
| 8* | Sasia e energjisë termike nga kogjenerimi | MWh | 376 566,30 |
| 9* | Humbjet ne rrjetin e transportit | MWh | 7 531,30 |
| 10 | Konsumi vetanak | MWh | 520,00 |
| 11 | Prodhimi neto I energjisë termike(ngrohjes) | MWh | 368 515,00 |
| 12 | Efikasiteti total I energjisë termike | % | **0,98** |
| 13 | Konsumi I ujit | m3 | 85 000,00 |
| 14 | Konsumi I elektricitetit | MWh | 10 100,00 |

| | Bilanci I ngrohjes | | |
|---|---|---|---|
| 13 | Sasia e ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit (e matur) | MWh | 368 515,00 |
| 14 | Furnizimi i konsumatorëve me ngrohje (e matur) | MWh | 342 719,00 |
| 15 | Humbjet e distribuimit | MWh | 25 796,00 |
| 16 | Humbjet e distribuimit ne përqindje | % | **7,00** |

| | Të dhënat për konsumatorë | | Konsumatorët Shtëpijak | Konsumatorët Komercial dhe Institucional | Total / mesatare |
|---|---|---|---|---|---|
| 17 | Kapaciteti i kontraktuar i ngrohjes | MW | 141 980,01 | 90 993,24 | 232 973,25 |
| 18 | Totali I sipërfaqes së ngrohur | m2 | 1 419 800,07 | 758 277,01 | 2 178 077,08 |
| 19 | Kërkesa specifike për kapacitetin e ngrohjes | W/m2 | 100,00 | 120,00 | 110 |
| 20 | Orët e ngarkesës së plotë | h | 1 500,00 | 1 500,00 | 1500 |
| 21 | Kërkesa për ngrohje (furnizimi me ngrohje I kalkuluar) | MWh | **212 970,01** | **136 489,86** | 349 459,87 |

| | Konsumi I karburantit | Sasia tona | Vlera (LHV) MWh/t | Energjia në karburant MWh |
|---|---|---|---|---|
| 22 | Nafta e rëndë (mazuti) | | | **0,00** |
| 23 | Nafta e lehtë (diesel D2) | | | **0,00** |

* Pozicionet e shënuara me yllëz vlejnë për rastet kur ekzistojnë stabilimentet.

| Aprovuar nga : | Punuar nga: |
|---|---|
| EMRI e MBIEMRI / Pozita | EMRI e MBIEMRI / Pozita |
| Fisnik Osmani -Kryeshef Ekzekutiv | Naim Bytyçi-Drejtor I Distribuimit |
| Nënshkrimi: | Nënshkrimi: |
| | Florent Hoxha -Drejtor I Prodhimit |
| | Nënshkrimi: |
| Data:22.08.2024 | Data:22.08.2024 |

NDËRMARRJA PUBLIKE - PUBLIC ENTERPRISE SHA-JSC-DD Termokos Ngrohtësia e qytetit PRISHTINË

PUBLIC ENTERPRISE
TERMOELEKTRANE NIKOLA TESLA
TeMPoNet
PRIŠTINE

Termokos
Ngrohtorja e qytetit

**Raportet e detajizuara në kuadër të Aplikimit për shqyrtim tarifor për sezonin ngrohës 2024/2025**

Të nderuar,

N.P."Termokos'SH.a, ka përgaditur dokumentacionin, raportet me të dhëna dhe informatat e kërkura nga ZRRE në kërkesën e datës 7.06.2023, në lidhje me fillimin e shqyrtimit të tarifave të energjisë termike për sezonin 2024/2025.

Përveç Pasqyrave Rregullative të plotësuara me të dhëna të planifikuara, Shpalosjes së Pasqyrës B ( të cilat ua dërgojmë si dokumente të bashkangjitura) , në këtë dokument janë dhënë edhe detajizime e shpjegime përkatëse që përmbajnë të dhënat e parashikuara për periudhën 15 tetor 2023 – 15 tetor 2024, që përfshinë sezonin e ardhshëm të ngrohjes 2024/2025.

Bazuar në kërkesën në fjalë, në këtë dokument janë paraqitur :

**1.Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B dhe në ngrohtoren qëndrore të NP "Termokos"SH.A**

**1.1 Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B**

- Në tabelën 1. është paraqitur energjia termike e planifikuar dhe kostoja e energjisë termike për sezonin 2024/25. Vlerësimi është bërë bazuar në kapacitetin e deklaruar dhe energjinë termike e cila derivon nga ky kapacitet ( Kapaciteti x 6.56), ndërsa nuk është përfshirë TVSH. Në kosto është llogaritur edhe Taksa e Licencës për Energjinë Termike. Kalkulimi i kostos së energjisë termike është bërë duke u bazuar në çmimin për kapacitet, energji termike dhe Taksës së Licencës për energjinë termike, të aplikuara gjatë sezonit 2023/2024.

** Plani për vitin 2025 ende nuk është aprovuar nga KOST dhe ME!

| PLANIFIKIMI PËR SEZONIN 2024/2025 | | | |
|---|---|---|---|
| | Kapaciteti I deklaruar MWh/h | Energjia MWh TER | Vlera e faturës pa TVSH/€ |
| Tetor 2024 | 3 394,00 | 22 264,64 | 103 135,51 |
| Nentor 2024 | 8 875,00 | 58 220,00 | 269 689,95 |
| Dhjetor 2024 | 10 964,00 | 71 923,84 | 333 169,65 |
| Janar 2025 | 12 060,40 | 79 116,22 | 366 486,61 |
| Shkurt 2025 | 9 762,50 | 64 042,00 | 296 658,95 |
| Mars 2025 | 9 045,30 | 59 337,17 | 274 864,96 |
| Prill 2025 | 3 302,20 | 21 662,43 | 100 345,93 |
| **Total :** | 57 403,40 | 376 566,30 | 1 744 351,56 |

Tabela 1. Energjia termike e planifikuar për sezonin ngrohës 2024/2025

## 1.2 Planifikimi I prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit në ngrohtore

Aktualisht sasia bruto e mazutit në të katër rezervuarët është 855 ton, kurse sasia neto (të shfrytëzueshme) janë 695 ton.

- Për sezonin 2024/2025, sa i përket prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet prodhuese në Ngrohtore (me mazut), NP"Termokos"sh.a nuk ka planifikuar prodhim të energjisë termike nga mazuti për disa arsye, e të cilat janë:

1. Nuk është vazhduar licenca për prodhim energjisë termike nga stabilimentet prodhuese në Ngrohtore (jemi në procedurë të kompletimit të dokumentacionit, e sqaruar më poshtë);

2. Stacioni i mazutit është larguar për shkak të ndërtimit të objektit administrativ, kurse për rivendosjen e tij kërkohet një kohë më e gjatë dhe kosto të lartë financiare.

3. Stabilimentet prodhuese në Ngrohtore janë të vjetëruara dhe në gjendje teknike jo të mirë, dhe riparimi i tyre kërkon një kosto jashtëzakonisht të lartë. Prandaj, Termokosi për vitin 2024 ka ndarë buxhet për të bërë vlerësimin teknik të kaldajave, oxhakut dhe stabilimenteve tjera përcjellëse tyre, nga ekipet e specializuara të kësaj fushe, nesë do të ia vlente të investohet në riparimin e tyre apo dekomisionimin e tyre.

4. Një fakt shumë me rëndësi është edhe ndotja e mjedisit e shkaktuar nga përdorimi i mazutit (duke pasur parasysh që ngrohtorja është në qendër të Prishtinës) , që nuk e arsyeton shumën e investimeve të reja për këto stabilimente, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit bazuar në direktivat e institucioneve vendore dhe evropiane.

Duke marrë parasysh gjendjen shumë të vështirë teknike të kaldajave ekzistuese, me të cilat nuk është operuar që nga funksionalizimi i sistemit të koogjenerimit, Termokos ka angazhuar ekspertë të specializuar në fushën përkatëse nga Fakulteti Teknik (FIM dhe FIN), të cilët së shpejti do të japin rekomandimin mbi vlerësimin e gjendjes ekzistuese të kaldajave, oxhakut dhe rezervuarëve të mazutit (R3 dhe R4), për t'i dekomisionuar apo për të bërë investime në impiantët ekzistues.
Andaj, NP"Termokos" sh.a bazuar në rekomandimet dhe konkludimet e ekspertëve të angazhuar, do të marrë vendim mbi altermativat në të ardhmen për të plotësuar kapacitetet e kërkuara në rast nevoje.

Licenca e Prodhimit të energjisë termike të NQ Termokos, ka skaduar në fillim të tetorit 2021, dhe në kuadër të plotësimit të kushteve për vazhdimin e kësaj licence nga ZRRE, është pajisja me Leje Mjedisore.

Termokos
Ngrohtorja e qytetit

**Në vijim po ju shpalosim kronologjinë e dërgimit të raporteve në MMPHI në kaudër të aplikimit për Leje Mjedisore të Integruar:**

Nga MMPHI është lëshuar Vendimi për Pëlqim Mjedisor për NP"Termokos"SHA me datë 27 .06.2022, Me datë 09.08.2022 kemi Aplikuar për Leje Mjedisore të Integruar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI), ku janë dërguar Aplikacioni i plotësuar dhe dokumentet mbështëtëse. Pas kësaj, mbështetur në kërkesat e MMPHI, me datë 08.12.2022 dhe 11.05.2023, kemi dërguar dokumentacionet plotësuese dhe riplotësimin e pikave të Aplikacionit, në të cilin, ndër të tjera është dërguar edhe "Raporti i matjeve të emisionit të gazrave djegëse dhe të pluhurit" nga Enti i hulumtimeve "INKOS" Sh.A, sipas matjeve të datës 02.02.2023 në ngrohtoren qendrore Termokos.

Me datë 08.04. 2024 është bërë pagesa e taksës për Leje Mjedisore të Integruar nga Termokos.

Duke vlerësuar se janë plotësuar kriteret dhe dokumentacionet e kërkuara nga MMPHI, jemi në pritje të vendimit të MMPHI për lëshimin e Lejes mjedisore të integruar, ashtu që NP "Termokos"sh.a të mund të fillojë procedurat në ZRRE për vazhdim të licencës së prodhimit të energjisë termike.

**2. Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë në sezonin 2024/2025**

Në tabelën 2. është pasqyruar planifikimi për furnizimin e konsumatorëve me energji termike / ngrohje, si dhe humbjet në rrjetin e transportit (TC Kosova B-NQ Termokos), vetkonsumi dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Në këtë tabelë nuk është përfshirë planifikimi i prodhimit të energjisë në ngrohtore, pasiqë ajo planifikohet vetëm për rastet emergjente.

| PLANIFIKIMI I SASISË SË ENERGJISË DHE HUMBJEVE PËR SEZONIN 2024/2025 | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sezona 2024/2025 | | | | | | | | | |
| | Kapaciteti I deklaruar | Energjia termike | Energjia termike e pranuar nga KEK | Humbjet e energjisë në rrjetin e transportit | Konsumi vetanak | Energjia neto e futur në rrjetin e shpërndarjes | Energjia e liferuar te konsumatorët | Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes | Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes |
| | MWh/h | MWh TER | MWh | MWh | MWh | MWh | MWh | MWh | % |
| Tetor 2024 | 3 394 | 22 265 | 445 | 21 819 | 40 | 21 779 | 20 255 | 1 525 | |
| Nentor 2024 | 8 875 | 58 220 | 1 164 | 57 056 | 60 | 56 996 | 53 006 | 3 990 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Dhjetor 2024 | 10 964 | 71 924 | 1 438 | 70 485 | 100 | 70 385 | 65 458 | 4 927 | |
| Janar 2025 | 12 060 | 79 116 | 1 582 | 77 534 | 120 | 77 414 | 71 995 | 5 419 | |
| Shkurt 2025 | 9 763 | 64 042 | 1 281 | 62 761 | 100 | 62 661 | 58 275 | 4 386 | |
| Mars 2025 | 9 045 | 59 337 | 1 187 | 58 150 | 70 | 58 080 | 54 015 | 4 066 | |
| Prill 2025 | 3 302 | 21 662 | 433 | 21 229 | 30 | 21 199 | 19 715 | 1 484 | |
| **Total :** | **57 403** | **376 566** | **7 531** | **369 035** | **520** | **368 515** | **342 719** | **25 796** | **7,0** |

Tabela2 .Planifikimi I energjisë termike dhe humbejve në rrjetin e transportit të energjisë dhe rrjetin e shpërndarjës së energjisë.

- Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë është planifikuar të jenë 2%, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 8%.

Humbjet e energjisë (ujit) në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 8%, pjesa më e madhe e këtyre humbjeve i referohet mbushjeve me ujë të trajtuar të rrjetit sekondar në objektet e reja, aty ku janë duke u instaluar nënstacionet e reja.

Me realizimin e projektit të KfW do të vazhdojë kyçja e 20 objekteve të reja në kuadër të zgjerimit dhe dendësimit të rrjetit, në lagjen Mati 1 , Arbëria dhe Qendër , rrjeti sekondar i të cilave mbushet vetëm nga rrjeti primarë. Gjithashtu në këtë nivel të humbjeve të energjisë (ujit) do të ndikojnë edhe rrjedhjet në segmente të caktuara të rrjetit, për shkak të vjetërsisë së rrjetit të shpërndarjes.

Andaj, elementet që ndikojnë në këtë nivel të parashikimit të humbjeve të energjisë (ujit) janë:

- Zgjerimi i rrjetit primarë,
- Pjesa sekondare e objekteve të reja dhe atyre ku janë ndërruar nënstacionet do të mbushet me ujë nga rrjeti primarë,
- Segmentet e vjetëruara të rrjetit të shpërndarjes,
- Testimet hidraulike,
- Si procedurë, aty ku është e mundur, rrjeti sekondarë në të gjitha nënstacionet mbushet nga rrjeti primar, me ujë të zbutur,
- Zbrazja e objekteve gjatë realizimit të projektit "Prishtina Heat Save" për instalimin e matësve individual të energjisë termike.

## 3. Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve

Në tabelën 3 , kemi paraqitur të dhënat aktuale për; numrin aktual i konsumatorëve aktiv, sipërfaqen ngrohëse dhe kapacitetin termik në varësi të llojit të konsumatorëve .

| Numri aktual i konsumatorëve | | | |
|---|---|---|---|
| **Sektori** | **Numri I konsumatorëve** | **Sipërfaqja /m²** | **Kapaciteti termik /MW** |
| **Sektori Banesor** | 22 434 | 1 392 279,27 | 139,23 |
| **Sektori Biznesor** | 1 859 | 137 604,40 | 19,26 |
| **Sektori Institucional** | 288 | 613 792,41 | 85,93 |
| **TOTAL** | **24 581** | **2 143 676,08** | **244,42** |

Tabela 3. Numri aktual i konsumatorëve, sipërfaqet respektive dhe kapaciteti termik

## 4. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2024/2025

Në vijim, në mënyrë tabelare kemi paraqitur të përmbledhura, të dhënat për sipërfaqen, konsumin vjetor të energjisë dhe konsumin specifik vjetor, sipas planifikimit për sezonin 2024/2025.

| Planifikimi - Sezona 2024/2025 | | | |
|---|---|---|---|
| | **Sipërfaqja/m²** | **Konsumi vjetor i energjis/MWh** | **Konsumi specifik KWh/m²/vit** |
| Konsumatorët shtëpiak | 1 419 800,07 | 213 821,89 | 150,6 |
| Konsumatorët Komercial dhe Institucional | 758 277,01 | 125 267,36 | 165,2 |
| **Total** | **2 178 077,08** | **339 033,78** | **157,9** |

Tabela 5.Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2024/2025

Termokos
Ngrohtorja e qytetit

**5.Planifikimi i kyçjeve të reja gjatë sezonit 2024/2025**

Lidhur me planifikimin e kyçjeve të reja , në Tabelën 6, janë paraqitur detaje për planifikimin e kyçjeve të reja gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë, kodin e objektit lokacionin dhe sipërfaqet ngrohëse.

Objektet e paraqitura në këtë tabelë, janë planifikuar të kyçen gjatë sezonës ngrohëse 2024/2025, bazuar në realizimin e Projektit të KfW për zgjerimin dhe dendsifikimin e sistemit të ngrohjes qëndrore.

Planifikimi I kyçjeve të reja për sezonin 2024/2025

**Objektet të cilat planifikohet të kyçen në sezonën 2024/2025**

| **Mati 1** | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. | Objekti | Kapaciteti/ kW | Sipërfaqja / m2 |
| 1 | MS23 | 250 | 5 355,00 |
| **Gjithësejtë** Mati 1: | | **250** | **5 355,00** |

| **CEE-Qendra lindje** | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. | Objekti | Kapaciteti/ kW | Sipërfaqja / m2 |
| 1 | CEE15 | 200 | 2 156,00 |
| 2 | CEE25 | 100 | 882,00 |
| 3 | CEE35 | 75 | 664,00 |
| 4 | CEE37 | 100 | 641,00 |
| 5 | CEE53 | 150 | 1 260,00 |
| 6 | CEE54 | 150 | 1 120,00 |
| 7 | CEE60 | 100 | 616,00 |
| 8 | CEE67 | 75 | 650,00 |
| **Gjithësejtë CEE-Qendra lindje** | | 950 | 7 989,00 |

| **Arberi** |
|---|

| Nr. | Objekti | Kapaciteti/ kW | Sipërfaqja / m2 |
|---|---|---|---|
| 1 | AR18 | 150 | 2 730,00 |
| 2 | AR21 | 250 | 4 250,00 |
| 3 | AR47 | 200 | 4 230,00 |
| 4 | AR22 | 200 | 4 175,00 |
| **Gjithësejtë Arbëria:** | | **800** | **15 385,00** |

| **Densifikim** | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. | Objekti | Kapaciteti / kW | Sipërfaqja / m2 |
| 1 | DAE2 | 50 | 391,00 |
| 2 | CE26 | 75 | 720,00 |
| 3 | CE29 | 100 | 960,00 |
| 4 | C10 | 150 | 1 860,00 |
| 5 | QP11 | 100 | 742,00 |
| 6 | QA5 | 75 | 670,00 |
| 7 | QA6 | 50 | 329,00 |
| **Gjithësejtë dendsifikim:** | | **600** | **5 672,00** |

| **Gjithësej planifikimi i kyçjeve të reja sezona 2024/2025:** | | | |
|---|---|---|---|
| | Nr. i nënstacioneve | Kapaciteti / kW | Sipërfaqja / m2 |
| Mati 1 | 1 | 250 | 5 355,00 |
| Arberi | 4 | 800 | 15 385,00 |
| CEE | 8 | 950 | 7 989,00 |
| Densifikim | 7 | 600 | 5 672,00 |
| **Gjithesejtë** | **20** | **2600** | **34 401,00** |

Tabela 6. Planifikimi i kyçjeve të reja gjatë sezonit 2024/2025

## 6. Planifikimi i Investimeve me vetfinancim.

### 6.1. Projekti për "Ndërtimin e Objektit të ri Administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse "

Meqenëse objekti ku aktualisht është i vendosur stafi administrativ i NP "Termokos"SH.A, është objekt shumë i vjetër, dhe nuk i plotëson kushtet elementare për punë, është paraqitur nevoja e realizimit të një projekti për ndërtimin e një objekti të ri në hapsirat e NP "Termokos "SH.A.

Ky projekt përfshinë Ndërtimin i objektit të ri administrativ me sipërfaqe 3,913.20 m², me etazhitet S+P+3 dhe Renovimin e hapësirave përcjellëse të NP "Termokos"SH.A .

Nënshkrimi i kontratës me kontraktorin për ndërtimin e objektit dhe renovimin e hapësirave përcjellëse, është bërë me datë 28.07 2023.

Vlera e kontratës është : 2,433,753.60 euro.

Deri tani, shuma e paguar për realizimin e projektit është: 590,872.26 euro

Njësia mbikqyrëse për implementimin e projektit -20,000.00 euro

Ky projekt në tërësi është duke u financuar nga NP" Termokos"sh.a me mjete vetanake .

Punimet për realizimin e këtij projekti kanë filluar në muajin gusht 2023. Sipas kontratës, afati për ndërtimin e objektit është 18 muaj.

Aktualisht punimet për ndërtimin e objektit janë në fazën e përfundimit të punimeve të ndërtimit të vrazhdë, ku janë bërë përgaditjet dhe masat për vendosjen e fasadës së jashtme. Ndarjet në objekt kanë filluar (në katin përdhesë kanë përfunduar) dhe ka filluar instalimi i rrjetit elektrik. Poashtu është bërë kyçja në gypin e ujësjellësit.

Punimet për realizimin e projektit janë duke u realizuar sipas planit dinamik.
Gjatë periudhës raportuese (15 tetor 2024/ 15 tetor 2025) planifikohet që të paguhet shuma prej **1,842,881.34euro** për realizimin e projektit dhe 20,000.00 euro për Njësinë mbikqyrëse për implementimin e projektit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detaje për investimet-projektet, që planifikohet të realizohen me mjete vetanake të N.P"Termokos"SH.A, gjatë periudhës tetor 2024/tetor 2025.

## 6.2 .Bashkëfinancimi për Projektin me KFW/Programi I Energjisë VIII dhe IX – Projekti "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qëndrore në qytetin e Prishtinës" (2021- 2024)

Projekti për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të ngrohjes është një nga projektet më të rëndësishme të NP "Termokos" Sh.A., dhe është në fazën përfundimtare.

Projekti është bashkëfinancuar nga Republika Federale e Gjermanisë dhe Qeveria e Luksemburgut nëpërmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe nga NP "Termokos" Sh.A.dhe është zhvilluar përmes dy pakove tenderuese.

Vlera e totale për dy pakot e projektit (T-1 dhe T-2) dhe për shërbimet e konsulencës, është 19.65milion euro, nga të cilat 10.62 milion euro janë paguar si donacion nga Qeveria Gjermane përmes KfW dhe Qeveria e Luksemburgut, ndërsa 9.03 milion euro janë duke u paguar nga NP"Termokos"SH.A. si bashkëfinancues i këtij projekti. Ky bashkëfinancim është dedikuar për mbulimin e kostos për zgjerimin e rrjetit në lagjet Mati 1 dhe Arbëria, për arsye se në krahasim me kohën kur është bërë projekti fillestarë, ka pasur ndërtime të objekteve të reja të cilat nuk janë përfshirë në projekt.

Projekti për Zgjërim dhe Rehabilitim të Rrjetit të Ngrohjes Qëndrore, si donacion i KFW dhe në bashkëfinancim edhe me NP Termokos, është i ndarë në dy pako tenderuese, T1 dhe T2.

1. Kontrata T-1, *MZ ID 201667575 / Procurement No. 505734 Supply and Installation of Heat Storage, Thermal Substations, Chemical Water Treatment and SCADA*

   Vlera e kontratës : **7,784,573.17 euro**

   Vlera e kontrates, pas shtesave të aprovuara: **8,438,479.73euro**
   Kontraktor : JV Brunata & ERGOTEM

   Pagesat e kryera deri tani janë: **6,900,538.77euro**

   Pa paguar janë: **1,537,940.96 euro**

- Meqenëse , për kontratën T-1, fondi i donacioneve ka mbaruar, shuma e mbetur pa paguar prej **1,537,940.96 euro** planifikohet të paguhet nga NP "Termokos "SH.A, si bashkëfinancues i këtij projekti gjatë periudhës raportuese ( 15 tetor 2024- 15 tetor 2025). Kjo e dhënë është paraqitur në tabelën 8.

Kontrata T-1 është e ndarë në dy seksione:

- Seksioni S1- Rezervuarët e nxehtesisë, Trajtimi i kimik i ujit dhe SCADA;
- Seksioni S2- Nënstacionet e nxehtësisë
- Kontrata për këtë pako tenderuese T-1, është nënshkruar në fund të dhjetorit 2021 dhe ka përfunduar me 14 Janar 2024. Punët e planifikuara kanë përfunduar në masën 99%.

➢ Për pjesën e projektit, në kuadër të T-1 që i refrohet ndërtimit të dy rezervuarëve të nxehtësisë me kapacitet 2x400m³, integrimi i këtij sistemi në SCADA si dhe rehabilitimit të sistemit për mbajtje të shtypjes në rrjetin shpërndarës, janë zhvilluar këto punime :

a. Ka përfunduar ndërtimi i dy rezervuarëve të nxehtësisë me kapacitet 800m³ (2 x 400m³), dhe janë mbushur rezervuarët me ujë nga rrjeti primarë i sistemit të ngrohjes dhe

b. Ka përfunduar izolimi i gypave dhe pajisjeve si pjesë e sistemit të rezeruarëve.

c. Kanë përfunduar punimet për zgjerimi i sistemit të pompave qarkulluese për rrjetin e distribuimit:

- Është instaluar një pompë e re qarkulluese (centrifugale), Q=860 m³/h, H=195m , P=25 bar se bashku me pajisjet elektrike për furnizim (konvertorët frekuentor) dhe elektromotor.
- Janë instaluar dy elektromotor me konvertorët frekuentor për pompat ekzistuese me karakteristikat: Q=860 m³/h, H=195m,P=25 bar.

d. Kanë përfunduar punimet për instalimin e Pompës së tretë në sistemin e koogjenerimit në HRS,

e. Është instaluar një Pompë e re qarkulluese (centrifugale), Q=1300 m³/h, H=195m, P=25bar, së bashku me pajisjet elektrike per furnizim (konvertorët frekuentor). Mbetet të përfundohet procesi i sinkronizimit me dy pompa të koogjenerimit.

f. Ka përfunduar modifikimi i sistemit SCADA ne HRS.

g. Finalizimi i të gjitha komponentave të sistemit SCADA- pas fillimit të sezonës së ardhshme, e mbuluar me defect notification period. Instalimi i Sistemit SCADA për monitorim të punës së nënstacioneve të reja dhe atyre të rehabilituara, do të mundësoj kontrollimin dhe udhëheqjen e punës së nënstacioneve. Gjithashtu përmes këtij sistemi do të bëhet e mundur leximi i matësve të energjisë në të gjitha nënstacionet.

h. Janë duke u zhvilluar punimet në rehabilitimin e sistemit për mbajtjen e shtypjes.

Punët e planifikuara , Seksioni S2 i kontratës T1 ( nënstacionet), kanë përfunduar në tërësi, janë instaluar:

- **325 nënstacione të reja në pjesën e zgjerimit dhe dendsifikimit,**
- **225 nënstacione të rehabilituara.**
- **31 nënstacione të automatizuara.**

Gjatë periudhës " defect notification period", kanë mbetur për tu bërë përmirësime të evidentuara në protokolet e pranim dorëzimit.

2. **Kontrata T-2, Project: "Improvement of District Heating System Pristina", Contract 2 - supply and installation of DH pipes, BMZ ID 201667575.**

Vlera e kontratës: **4,349,630.52 €;**

Vlera e kontrates, pas shtesave të aprovuara: **8,026,062.26 euro**

Pagesat e kryera deri tani janë: **8,007,543.11euro**

Pa paguar janë: **18,519.15 euro**

Për periudhën raportuese (tetor 2024- tetor 2025) **për kontratën T-2,** planifikohet të realizohet vlera prej **18,519.15 euro.**

Shërbimet e konsulencës për T1 dhe T2 janë: 3,185,238.00 euro.

Shërbimet e konsulencës për T1 dhe T2 të papaguara janë: 124,000.00 euro.

Për periudhën raportuese (tetor 2024- tetor 2025) për Shërbimet e konsulencës, planifikohet të realizohet vlera prej **124,000.00 euro** nga NP"Termokos"SH. A.

Vlera e totale për dy pakot e projektit (T-1 dhe T-2) dhe për shërbimet e konsulencës, që planifikohet të realizohet për periudhën (15tetor 2024-15 tetor 2025), është **1,680,460.11 euro.** Kjo shumë duhet të paguhet nga NP"Termokos"SH. A. si bashkëfinancim, për shkak se fondet nga donacionet për këtë projekt kanë mbaruar. Ky investim është paraqitur si investim vetanak në Tabelën 8. Planifikimi i Investimeve me vetfinancim.

**Sqarim:** Bashkëfinancimi nga NP"Termokos"SH. A. është dedikuar për mbulimin e kostos për zgjerimin e rrjetit në lagjet Mati 1 dhe Arbëria, për arsye se në krahasim me kohën kur është bërë projekti fillestarë, ka pasur ndërtime të objektetve të reja.

Në këtë kontratë përfshihet instalimi I rrjetit në pjesët e qytetit ku planifikohet zgjerim dhe densifikim I rrjetit të ngrohjes qëndrore, si dhe rehabilitim I segmenteve të caktuara të rrjetit ekzistues të tubacioneve.

Kontrata me kontraktorin ALL ZONE është nënshkruar në fund të dhjetorit të vitit 2020, ndërsa punimet konkrete ne teren kanë filluar në fillim të majit të vitit 2021.

Punët e planifikuara me këtë projekt për instalimin e rrjetit të ngrohjes kanë përfunduar. Punët e planifikuara , me kontratën T2 (furnizimi dhe instalimi i i gypave të paraizoluar),në kuadër të zgjerimit dhe rehabilitimit të rrjetit të ngrohjes kanë përfunduar në tërësi, janë instaluar:

- **13 km gyp të paraizoluar - Rehabilitim /zëvendësim I rrjetit të ngrohjes,**
- **36 km gyp i paraizoluar - Zgjerimi dhe dendsifikimit të rrjetit të ngrohjes .**

Aktualisht jemi në fazën e pranim dorëzimit të projektit:

- Rrjetit te zgjeruar,
- Rjetit te rehabilituar,
- Sistemit per detektim te rrjedhjeve.

**Sqarimet për shtesat e projektit të KfW :**

Të gjitha ndryshimet dhe tejkalimet e bëra për projektin aktual të KfW- "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacione të reja", janë paraqitur në "Raportin e progresit nr. 19" të cilin ua dërgojmë të bashkangjitur në e-mail dhe sqarimet për ndryshimet e bëra për tenderin T1 dhe T2, i gjeni në këtë dokument : Shtesat për tenderin T1, në Tabelën 3 faqe 4 , ndërsa shtesat për tenderin T2 të cilat edhe e bëjnë diferencën, janë paraqitur në tabelën 4 faqe 13.

Në këto tabela në kolonën e fundit janë dhënë edhe arsyetimet në formë të shkurtë për shtesat e projektit .

Arsyetimet për këto shtesa të projektit më gjerësisht janë paraqitur në Minutat e Takimeve të bashkangjitura me këtë raport:

**1. Shtesa për Variation Order nr. 1** -sqarohen në " Minutat e takimit M2 " të datës 10.03.2022 në pikën 13.2 (dokument i bashkangjitur).

2. **Shtesa për Clame 1 dhe 2**- sqarohen në "Minutat e takimit M14" të datës 08.04.2022 në pikën 12 (dokument i bashkangjitur).

3. **Shtesa për Variation Order nr.3** (vlera 45 846.2 euro) - është për ndryshimin e diametrit të gypit furnizues nga DN400 në DN450 për segmentin nga ish "Hotel Baci" deri te Ngrohtorja e Spitalit.

4. **Shtesa për Variation Order nr.4** - sqarohen në "Minutat e takimit M15" të datës 10.05.2022 në pikën 4 – Arbëria (dokument i bashkangjitur).

Ndërsa, **Kost Benefit Analizë** për këtë projekt Termokosi nuk posedon.

***6.3.*** **Bashkëfinancimi për Projektin e MCC –** ***Projekti*** **"Supply, Installation, Maintenance of relevant equipment and services for the introduction of consumption based heat metering and thermostatic heating valves in District Heating, Prishtina"** ***për periudhën (tetor 2023- tetor 2024)***

Ky projekt mbeshtetet nga Qeveria Amerikane -MCC me 10.9 mil. dollar grant , Komuna e Prishtinës me 2 mil. Euro dhe Termokos me 1 mil.si bashkëfinancues të këtij projekti.

Kontrata për këtë projekt është nënshkruar në Prill 2022, në mes të MFK ( Millenium Foundation-Kosova ) dhe kontraktorit "ENERCO LLC" Sh.P.K – Prishtinë, dhe ka filluar së zbatuari me 27.07.2022.

Pas Nëntorit të vitit 2022, është bërë një ndryshim dhe riorganizim në projekt. Bazuar në Marrëveshjen Trepalëshe në mes të MCC, Komunës së Prishtinës dhe Termokosit, projekti ka kaluar në përgjegjësi të Termokosit. Fondet e mbetura të MCC, do të menaxhohen nga PIU e këtij projekti, e cila deri në fund të projektit është pjesë e Termokosit.

**Vlera e projektit pas shtesave të aprovuara : 12, 910, 384.18 euro.**

**1. Vlera e kontrates, pas shtesave të aprovuara: 10,149,722.48 euro,**

**Të paguara janë: 9,542,749.91euro,**

**Pa paguar janë : 606,972,57euro ,**

**2. Shërbimet e konsulences**: pas shtesave të aprovuara: **2,760,663.00 euro,**

**Të paguara janë : 2,440,663.00 euro .**

**Pa paguar janë :320,000.00 euro .**

Vlera që planifikohet të realizohet për periudhën raportuese (tetor 2024-tetor 2025), është **926,972.57 euro**, e cila paraqet vlerën e pa paguar të kontratës prej **606,972,57euro** për furnizimin e pajisjeve dhe instalim, ndërsa **320,000.00 euro** për shërbime të konsulencës,do të paguhet nga NP"Termokos"SH.a si bashkëfinancues i këtij projekti, pasiqë fondet nga donatorët Qeveria Amerikane -MCC dhe Komuna e Prishtinës kanë mbaruar.

Ky investim është paraqitur si investim vetanak në Tabelën 8. Planifikimi i Investimeve me vetfinancim.

- Në kuadër të këtij projekti, do të instalohen matësit e energjisë termike dhe valvulave termostatike në rreth 300 ndërtesa të banimit kolektiv, respektivisht rreth 17,500 konsumatorë shtëpiak dhe komercial.

Do të Instalohen rreth 64,000 alokatorëve të nxehtësisë dhe rreth 5,100 matës individual të energjisë termike dhe 85,500 valvula termostatike në radiatorët e konsumatorëve, pompa dhe valvola balancuese në nënstacione. Gjithashtu do të instalohet Sofweri për lexim, matje, faturim dhe sistem të kontabilitetit. Projekti është duke u zhvilluar për të përfunduar instalimin e pajisjeve të mbetura.

| RAJONI | Nr. i Apartmaneve të përfunduara | Tot. i nr. të Valvulave | Tot. i nr. të Alokatorve | Tot. i nr. të Termokokave | Tot. nr. Njehsorëve të nxehtësisë | Tot. Pompat qarkulluse | Tot. Valvola ballancuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ULPIANA | 2336 | 8775 | 7523 | 8775 | 0 | 37 | |
| K. E DIELLIT | 4227 | 21168 | 13421 | 21168 | 944 | 39 | |
| DARDANIA | 3197 | 13856 | 13729 | 13856 | 0 | 23 | |
| QENDRA | 2710 | 12367 | 9719 | 12367 | 705 | 132 | 18 |
| KALABRIA | 1444 | 6956 | 2805 | 6956 | 690 | 4 | |
| MATI I | 3555 | 14447 | 3053 | 14447 | 1448 | 0 | |
| Total: | 17469 | 77569 | 50250 | 77569 | 3787 | 235 | 18 |

Tabela 7. Sasia e instalimeve hidraulike e realizuar për projektin e MCC deri me 30 maj 2024

**Sqarimet për shtesat e projektit të MCC :**

a) Sa i përket shtesës së vlerave monetare të investimit si në blerjen dhe instalimin e matësve dhe pajisjeve tjera poashtu edhe për shërbimet e konsulencës, këto shtesa janë aprovuar në bazë të Amandamentit Nr.6 (Referencë:BD/QPBS/2021) të marrëveshjes së kontraktuar për prokurimin e mallërave dhe shërbimeve përkatëse të datës 06.12.2023 (për kontraktorin) dhe Amandamentit Nr.4

(Referencë:RFP/MFK/20219/QSBS/No.026) për Marrëveshjen me konsulencë për mbikqyrjen e kontrollit të cilësisë për zbatimin e DMH, të datës 15.12.2023, me këto kushte :

1. Të ruhen çmimet e kontratës paraprake ,
2. Ngritja e çmimit të kontratës t'i përmbahet buxhetit të alokuar për projektin "Prishtina Heat Save".

a) Kërkesa për pajisje shtesë ka ardhur si rezultat i kërkesës së kontraktorit për plotësimin e numrit të konsumatorëve për 17 500 konsuamtorë ( për konsumatorët tek të cilët nuk kanë pasur çasje në lagjet tjera, të zëvendsohen /plotësohen më konsumatorët në lagjen Mati 1). Gjatë survejimit është vërejtur se në lagjen "Mati 1" sistemi i ngrohjes qëndrore është sistem horizontal, sipas të cilit është nevojitur instalimi i valvolave trekahore, të cilat nuk kanë qenë të parapara në kontratën bazë.

b) Pajisjet shtesë janë bërë në bazë të survejimit emergjent për shkak të porosisë së shpejtë dhe janë paraparë për lagjen Mati 1, dhe për këtë nuk ekziston survejim (një projekt-propozim ) i detajizuar.

Meqenëse projekti i MCC përfundon në janar të vitit 2025, nga fonet e NP"Termokos"Sh.a si bashkëfinancues i këtij projekti duhet të ekzekutohet shuma e paraqitur në raport prej 926,972.57 euro.

Në tabelat në vijim (tab. 8) janë paraqitur sasia dhe vlerat monetare për pajisjet shtesë.

Termokos
Ngrohtorja e qytetit

| SHTESAT PËR PAJISJET E PROJEKTIT TË MCC-DERI ME 31.01.2025 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Astetet/Euro | Materiali instalues /Euro | Punët për instalim/Euro | Total /Euro |
| Valvola termostatike trekahore | 257 631.00 | 13 368,96 | 370 919,01 | 641 918,97 |
| Pajisjet për mbledhjen e të dhënave (Data collection) | 105 656,02 | 74 239,17 | 17794,41 | 197 689,60 |
| Totali I shtesave sipas "Amandamentit Nr.6 "(BOQ e re për Pajisjet për mbledhjen e të dhënave (Data collection)dhe Valvola termostatike trekahore) | **363 287,02** | **87 608,13** | **388 713,42** | **839 608,57** |

| SHTESAT PËR KONSULENCËN E PROJEKTIT TË MCC-DERI ME 31.01.2025 | | |
|---|---|---|
| | PERIUDHA | VLERA /Euro |
| Raportet mujore (12) | Shkurt 2024-Janar 2025 | 240,000.00 |
| Kampanja e vetëdijësimit, marketingu | Shkurt 2024-Janar 2026 | DERI 150,000,00 |
| Totali I shtesave sipas "Amandamentit Nr.4 ": **390,000,00 Euro** | | |

| SASIA E PAJISJEVE SHTESË | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Valvola termostatike trekahore -të radiatorit | | Data Collection/Transmission gateway | |
| | Sasia /copë | Çmimi /€ | Sasia /copë | Çmimi /€ |
| BOQ 1,2 (MFK) | 2 000 | 74 000,00 | 2 871 | 635 606,62 |
| BOQ e re (për 3500 apartamente në Mati 1) | 6 963 | 257 631,00 | 391 | 197 689,60 |
| Total : | **8 963** | **331 631,00** | **3 262** | **833 296** |

Tabela 8. Sqarimet për shtesat për projektin e MCC

Në tabelën në vijim është paraqitur Planifikimi i Investimeve me vetëfinancim.

Termokos
Ngrohtorja e qytetit

| Investimet me mjete vetanake të Termokosit (15 tetor 2024-15 tetor 2025) | | |
|---|---|---|
| **Distribuimi** | | |
| **Përshkrimi** | **Periudha (tetor - dhjetor 2024)/ €** | **Periudha (janar -tetor 2025)/€** |
| Gypa të paraizoluar | | 65,000.00 |
| Këmbyes | | 20,000.00 |
| Pompa qarkulluese | | 40,000.00 |
| Valvola dhe Filtra | | 30,000.00 |
| Kalorimatës | | 10,000.00 |
| Ndërtim i pusetave dhe riparimi i rrugëve dhe rehabilitim I ambienteve të punës | 22,500.00 | 32,500.00 |
| Furnizim me automjete (2 kombi për teren) | 60,000.00 | |
| **Total** | 82,500.00 | 197, 500.00 |
| **Total Distribuimi : 280,000.00 euro** | | |
| **Prodhimi** | | |
| **Prodhimi -planifikimi 2024-2025** | | |
| **Përshkrimi** | **tetor -dhjetor 2024 /€** | **(janar -tetor 2025)/€** |
| Furnizim me fletëza dhe diktuna për këmbyes të nxetsisë 50MW me sherbim( me montim) | | 120,000.00 |
| Pjesë rezervë për pompa KSB | | 50,000.00 |
| Pjesë rezervë për sistem të koogjenerimit | | 70,000.00 |
| Servisimi I vinçit ure ne NQ dhe në stacion Bregu I Diellit | | 10,000.00 |
| Kalibrimi i matësve të energjisë në stacionin HES-HRS | | 10,000.00 |
| Kontejnerë për stafin që punon në stacionin HES_TC-B | | 20,000.00 |
| Pjesë rezervë ne sistem te degasifikimit ne koogjenerim | | 7,000.00 |
| Pompa per mbajtjen e presioniit në rrjet te koogjnerimit | | 10,000.00 |
| Shpenzimet për bazhdarimin e valvolave siguruese | | 5,000.00 |
| Freskim I elektromotorve te pompave qarkulluese ne stacionin Bregu I Diellit | | 5,000.00 |

| | | |
|---|---|---|
| Llaguna (riparim I izolimit) | | 50,000.00 |
| Inverter VfD bashk me panelin mbrojtës për elektromotorin e pompës qarkulluese 62P1/62P2 | | 20,000.00 |
| Module për komunikim brenda sistemit PLC | | 15,000.00 |
| Funksionalizimi i sistemit të kamerave HES/HRS | | 7,000.00 |
| Komponente elektrike/automatike | | 12,000.00 |
| Instrument të rrjedhjes | | 20,000.00 |
| | | |
| **Total Prodhimi : 431,000.00 euro** | | |
| **Administrata** | | |
| **Përshkrimi** | **Periudha (tetor - dhjetor 2024)/ €** | **Periudha (janar -tetor 2025)/€** |
| Ndërtimit të objektit Administrativ | 1,209,127.74 | 633,753.60 |
| Njësia mbikqyrëse për implementimin e projektit | 10,000.00 | 10,000.00 |
| Furnizimi me Kompjuter, Llaptop dhe printera, ploter . | | 20,000.00 |
| Blerja e licenceve të Sistemit Operativ dhe Microsoft Office për të gjithë përdoruesit e PC. | | 60,000.00 |
| **Total:** | 1,219,127.74 | 723 753,60 |
| **Total Administrata** : 1 942 881,34 euro | | |
| **Total I investimeve vetanake (distibuim, prodhim dhe administrate) - 2, 653, 881.34 euro** | | |
| **Investimi - Bashkëfinancimi për Projektet zhvillimore** | | |
| **Përshkrimi** | **Periudha (tetor - dhjetor 2024)/ €** | **Periudha (janar -tetor 2025)/€** |
| Bashkëfinancimi për Projektin me KFW/Programi i Energjisë VIII dhe IX - per realizimin e projektit — Pako tenderuses T1 | 1,537,940.96 | |
| Pako tenderuese T2 | 18,519.15 | |
| Shërbimet e konsulencës | 124,000.00 | |
| Total Bashkëfinancimi për Projektin me KFW | **1,680,460.11** | |
| | | |
| Bashkëfinancimi për Projektin e — Për projektin | 606,972,57 | |

| | | |
|---|---|---|
| MCC – Instalimi i matësve të energjisë termike | Shërbimet e konsulencës | 320,000.00 |
| Total Bashkëfinancimi për Projektin e MCC | | **926,972.57** |
| | | |
| **Total Bashkëfinancim: 2,607,432.68 euro** | | |
| | | |
| **Grand Total - Investimet vetanake: 5,261,314.02 euro** | | |

Tabela 9. Planifikimi i Investimeve me vetëfinancim

## 7. Planifikimi i Investimeve nga Donacionet gjatë periudhës ( 15 tetor 2024- 15 tetor 2025)

Në kuadër të investimeve të planifikuara nga donacionet janë përfshirë këto projekte :

1. Projekti i prodhimit të energjisë termike përmes energjisë diellore "Solar 4 Kosova",
2. Projekti për dyfishim të kapaciteteve termikenga 140 në 280MW.

### 7.1. Projekti i prodhimit të energjisë termike përmes energjisë diellore "Solar 4 Kosova"

Projekti për prodhimin e energjisë termike përmes energjisë diellore "Solar 4 Kosova II ", është projekti më i madhi në Ballkan dhe i dyti në Evropë pas Danimarkës, në fushën e energjisë solare.

Projekti përfshinë ndërtimin e impiantit termik diellor dhe integrimin në sistemin ekzistues të ngrohjes qëndrore duke përfshirë zgjerimin e rrjetit deri në 50MW. Ky projekt parashihet të ketë koston në vlerë prej 80.7 milion euro. Projekti "Solar 4 Kosova II" do të financohet nga Qeveria Gjermane nëpërmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) në vlerë të 53.1 milion eurove, prej të cilave 21.5 milion euro grant dhe 31.6 milion euro kredi, BERZH me 23.2 milion euro kredi dhe 4.4 milion euro nga NP "Termokos"Sh.A si bashkëfinancues i këtij projekti. Në kuadër të këtij projekti, do të vendosen panelet solare prej 58 000 m², gjë që do të ndikojë në rritjen e kapacitetit termik për 50MWth,

duke mundësuar zgjerimin e rrjetit dhe kyçjen në rrjetin e ngrohjes edhe për rreth 12 mijë konsumatorë të rinjë në lagjet (Arbëria, Tophane dhe Gjinaj).Pjesë e projektit është edhe ndërtimi i rezervuarit të energjisë termike me kapacitet prej 410 000m³ ujë.

Sa i përket zhvillimeve për këtë projekt, kanë përfunduar :

- Studimi i fizibilitetit dhe
- Projekti VNMS (Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social ), i punuar nga CES-iC dhe financuar nga KFW,
- Është definuar dhe aprovuar lokacioni në zonën Hade e Re prej 25 ha tokë, për vendosjen e paneleve solare dhe rezervuarit të energjisë ngrohëse,
- Është përzgjedhë kompania konsulente për projektin, kompania iC –CES Consulenten nga Vienna. Nënshkrimi i kontrates është bërë në muajin Janar 2024.

Ndërsa, aktivitetet në proces (nga Kompania konsulente iC-CES), janë:

- Përgaditja e dizajnit;
- Përgaditja e dokumentacionit tenderues ( Termave të referencës) për kompaninë punëkryese;
- Publikimi i tenderit për zgjedhjen e punëkryesit, planifikohet të bëhet në muajin dhjetor 2024.
- Është duke vazhduar puna për sigurimin e lejeve dhe pëlqimeve për punët që kanë të bëjnë me analizim të terenit ( shpimet për analiza gjeomekanike ), ndikimin e linjës 110kV në parkun e solareve, rrjetin e ujësjellësit në lagjën Arbëria, etj.

Për periudhën raportuese (15 tetor 2024- 15 tetor 2025) për projektin "Solar4 Kosova", nga donacionet planifikohet të realizohet vlera prej **12.244 mil. euro,** nga të cilat **11. 224 mil. euro** të dedikuara për zhvillimin e projektit dhe **1 mil. euro** për shërbimet e konsulencës.

Ky investim është paraqitur si investim nga donatorët në Tabelën 9.

## 7.2. Projekti për dyfishimin e kapaciteteve të ekstraktimit të energjisë termike nga sistemi i kogjenerimit nga 140MWTH në 280MWTH

Ky projekt është pjesë e studimit te Masterplanit për zgjerim të rrjetit dhe sigurimin e kapaciteteve shtesë të energjisë termike përmes dyfishimit të kapaciteteve gjeneruese, nga 140 në 280MWTH, nga TE Kosova B dhe parashihet që vlera e këtij projekti të arrijë shumën prej 50 milion euro. Për Financimin e këtij projekti, nga Komisioni Europian janë zotuar 17.5milion euro, nga Komuna e Prishtinës janë zotuar 5 milion euro (për 5 vite), gjithashtu edhe Termokosi si bashkëfinancues i këtij projekti ka zotuar mjetet prej 2.5 milion euro (nga 0.5mil. euro për vit).
Në qershor të viti 2022, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, në mes Bankës Europiane për Investime (EIB), Ministrisë së Financave të Republikes së Kosoves dhe Termokosit, për fondin në vlerë prej 1.5 mil. euro për financimin e studimeve paraprake për këtë projekt.
**Sqarim:** Nga kapaciteti gjenerues prej 140MWTH i cili do të realizohet me projektin për dyfishimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë termike, 40 MWTH energji termike do të ndahen për komunën e Obiliqit, ndërsa 100 MWTH energji termike do të mbeten për NP "Termokos"sh.a.

Sa i përket zhvillimeve për këtë projekt, në proces të realizimit janë këto aktivitete:

- Kompania konsulente ka prezentu dizajnin inicial për instalimin e gypave ne salën e turbinave TUH,HES1&HES2 si dhe rrjetit HES-2 HRS-2.
- Është duke u punuar në përditësimin e Masterplanit të ri. Kompania ka prezentu zonimin e ri ( zonat ku duhet të zgjërohet rrjeti ).
- Është duke u përgaditur vlerësimi financiar i projektit;
- Është përfundu Raporti mbi Vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) dhe është dërgu te Banka EIB për aprovim.
- Është prezentu trasa e propozuar për rrjetin Termoelektrane Kosova B- Termokos.
- Është definuar lokacioni për HRS-2. Objekti ekzistues "Termokis" do të destinohet për këtë qështje.
- Është duke u punuar në dokumentacion per leje te ndryshme: identifikimi i parcelave përgjatë trasesë, dokumentacioni për shpronësim, pelqim mjedisor etj.
- Është prezentu kalkulimi bazë hidraulik i rrjetit transmetues të kogjenerimit duke përfshi edhe kyçjen për komunën e Obiliqit dhe impiantin e Solareve.

Për periudhën raportuese (15 tetor 2024- 15 tetor 2025) për projektin "Dyfishimi i kapaciteteve termike nga 140$MW_{TH}$ në 280$MW_{TH}$", nga donacionet planifikohet të realizohet vlera prej **1 mil. euro,** të dedikuara për zhvillimin e projektit . Ky investim është paraqitur si investim nga donatorët në Tabelën 10.

**Planifikimi i Investimeve nga donacionet për periudhën (15 tetor 2024- 15 tetor 2025)**

| | Donatori | Projekti | | Total ( tetor 2024-dhjetor 2024) /€ | (janar 2025-tetor 2025) /€ | Total /€ |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | EBRD, KfW, Komisioni Europian | "Solar 4 Kosova II " | për projekt | 465 000,00 | 10 759 000,00 | 11 224 000,00 |
| | | | për konsulencë | **250 000,00** | **750 000,00** *(pagesë avansi)* | **1 000 000,00** |
| **Total për projektin "Solar 4 Kosova II " : 12 244 000,00€** | | | | | | |
| 2 | Komisioni Europian dhe (EIB ) | Dyfishim të kapaciteteve termike nga 140 MW në 280MW | për projekt | | **1,000,000.00** | |
| **Total investimet nga donacionet : 13 244 000,00 €** | | | | | | |

Tabela 10. Përmbledhje e Investimeve të planifikuara nga donacionet

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Prishtinë, 22/08/2024

# Përgjigjet në komentet e ZRRE në Aplikacionin për Tarifa të NQ Termokos për sezonin 2024/2025

## Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të veta ka filluar shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos për sezonin 2024/2025 ; në këtë aspekt me dt. 31 maj 2024, NQ Termokos-it i është dërguar shkresa-njoftimi për fillimin e shqyrtimit tarifor për sezonin 2024/2025 dhe "Plani i zbatimit dhe orari". Në vijim, me dt. 05 qershor 2024 NQ Termokos-it i është dërguar Kërkesa për të dhëna dhe informata për shqyrtimin tarifor, ku janë specifikuar të dhënat, informatat dhe dokumentet që NQ Termokos duhet të dorëzoj për shqyrtimin tarifor. Me 04 korrik 2024 NQ Termokos ka dërguar përmes e-mailit aplikacionin tarifor për sezonin 2024/'25.

Në këtë dokument janë dhënë komente për përmbajtjen e aplikacionit për tarifa në përgjithësi, si dhe për përmbajtjen e secilit dokument të dërguar në kuadër' të aplikacionit. Komentet kanë të bëjë me kompletimin / jo-kompletimin e aplikacionit, duke treguar se cilët dokumente janë dorëzuar dhe cilat do duheshin dorëzuar. Më tutje komentet elaborojnë në përgjithësi dhe japin udhëzime për korrektësinë e dokumenteve që përmban aplikacioni për tarifa, dhe gjithashtu, pas vlerësimit të secilit dokument të dërguar, kërkohen korrigjimet e nevojshme, informata dhe shpjegime shtesë.

## Përmbajtja e Aplikacionit për Tarifa

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar në formë elektronike nga NQ Termokos përmban këto dokumente:

1) Pasqyrat Rregullative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2024-2025:
   a) Pasqyra A e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;
   b) Pasqyra B e të ardhurave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të ardhurat dhe kostot (shpenzimet);
   c) Pasqyra C e faturimit dhe arkëtimit – të dhënat dhe informatat për sipërfaqet e ngrohjes, kapacitetet dhe sasitë e energjisë termike, faturimin dhe arkëtimin e konsumatorëve;
   d) Pasqyra D e investimeve – të dhënat dhe informata për investimet kapitale të planifikuara;
   e) Pasqyra E teknike - të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve (supozimet për kalkulimin e kërkesës reale për ngrohje, prodhimin dhe furnizimin e ngrohjes, dhe sipërfaqja ngrohëse e parashikuar).

2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutore për vitin 2023 – dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale:
   a) Pasqyra e fitimit / humbjes (Bilanci i suksesit);
   b) Bilanci i gjendjes;
   c) Pasqyra e rrjedhjes së parasë; dhe
   d) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.

3) Të dhënat dhe informatat tjera dhe dokumentet mbështetëse:

Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

a) Shpalosja (zbërthimet e detajuara) e pasqyrës B;
b) Planifikimin e prodhimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi bazuar në parashikimin e kapaciteteve dhe sasisë së energjisë termike, si dhe të humbjeve përkatëse në rrjet; po ashtu edhe planifikimin e kostos së energjisë termike nga ko-gjenerimi.
c) Planifikimet për sipërfaqen ngrohëse dhe konsumin e konsumatorëve për sezonin e ngrohjes 2024/25 bazuar në konsumin specifik të parallogaritur, si dhe humbjet në rrjet; gjithashtu edhe të dhënat të përmbledhura nga baza e konsumatorëve – numri i konsumatorëve, sipërfaqet ngrohëse dhe kapaciteti termik përkatës.
d) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2024/25;
e) Detaje dhe shpjegime për investimet e planifikuara me vetë-financim dhe nga donacionet;
f) Lista e nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);
g) Lista e aseteve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e aseteve (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale); dhe
h) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga ko-gjenerimi (dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);

**Komente për Përmbajtjen e Aplikacionit të Tarifave**

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar nga NQ Termokos është mjaft i kompletuar dhe në përputhje me kërkesat e ZRRE-së. Përveç pasqyrave rregullative dhe pasqyrave financiare statusore janë dhënë edhe të dhëna, informata shtesë në formë të detajimeve (shpalosjeve) dhe shpjegime shtesë për pozicionet kryesore të kostove operative dhe kapitale (investimeve), si dhe dokumente mbështetëse.

**Komentet për secilin dokument të dorëzuar në ZRRE**

1) Pasqyrat Rregullative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2024-2025:

a) Pasqyra 'A' e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;

Në pasqyrën A janë paraqitur asetet në vlerën fillestare (kostoja e blerjes), është dhënë zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme (vlera neto kontabël). Gjithashtu asetet janë paraqitur të ndara sipas aktiviteteve të licencuara: prodhimi dhe shpërndarja e furnizimi, si dhe asetet e përbashkëta. Nga vlera fillestare (kostoja e blerjes) në vlerë totale 79,295,248 € është zbritur zhvlerësimi i akumuluar në vlerë prej 29,645,027 €, që rezulton në vlerë neto kontabël prej 49,650,221 €. Nga analiza e aseteve ekzistuese dhe investimeve të reja të planifikuara vërehet se në vlerën totale të aseteve janë përfshirë edhe investimet e reja të planifikuara për periudhën e shqyrtimit tarifor. Sidoqoftë ZRRE, do të bëj llogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) bazuar dhe në përputhje me metodologjinë tarifore duke marrë parasysh RAB fillestarë, që paraqet RAB-in e realizuar në sezonin 2023/2024, dhe investimet e planifikuara të arsyeshme dhe të lejuara në këtë shqyrtim tarifor.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Sa i përket kësaj pike ashtu siç e keni përshkruar edhe ne kemi raportuar në Pasqyren A .

b) Pasqyra 'B' e të hyrave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të hyrat dhe kostot.

- Të hyrat nga shitja e ngrohjes janë paraqitur në vlerë totale prej 10,080,698 €. Nga 'Shpalosja e pasqyrës B' vërehet se këtu përfshihen të hyrat nga faturimi për shërbimin e furnizimit me ngrohje për konsumatorët shtëpiak dhe komercial e institucional; kjo vlerë prej 9,553,701 €, e që përputhet me faturimin e planifikuar për shërbimin e furnizimit me ngrohje në Pasqyrë 'C'. Megjithatë sa i përket të hyrave nga shitja e ngrohjes duhet theksuar se këto do të përcaktohen gjatë shqyrtimit tarifor në vlerën e lejuar që do të mbuloj kostot operative dhe ato kapitale (zhvlerësimin dhe kthimin në asete).

Ndërsa në shumën totale të të hyrave (10,185,698 €) janë paraparë edhe të hyra tjera të lejuara në vlerë 105,000 €; nga shpalosja vërehet se në këtë shumë janë përfshirë të hyrat nga kyçjet, nga shërbimet në rrjetin sekondarë etj. Lidhur me këtë është vërejtur një gabim në shpalosjen e Pasqyrës 'B' – pozicioni: 'zbritjet e lejuara nga faturimi' në vlerë 10,000 € nuk janë zbritur por janë shtuar në shumë e të hyrave tjera të lejuara. Duhet të rishikoni këtë pozicion dhe të bëni përmirësimin adekuat.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Sqarimin për këtë pikë do ta japim pas pranimit të raporteve nga "Enerco".

- Për koston e energjisë termike nga ko-gjenerimi është paraqitur shuma prej 1,744,352 €. Kjo kosto e parashikuar gjithashtu është llogaritur në: Planifikimin e kostos së energjisë termike nga ko-gjenerimi (nën 'b') duke u bazuar në kapacitetet dhe sasitë e planifikuara të energjisë termike nga ko-gjenerimi dhe çmimet përkatëse, ku është llogaritur e njëjta vlerë. Nga analizimi i kësaj kostoje dhe detajeve të ofruara është vërejtur se kjo kosto korrespondon me sasinë e planifikuar të energjisë termike të ekstraktuar nga ko-gjenerimi dhe çmimet aktuale përkatëse për sasi të energjisë dhe kapacitet. Gjithashtu, sa i përket planifikimeve të prodhimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi duhet theksuar se kryesisht përputhen me planifikimet e Bilanceve të energjisë. Përderisa planifikimet janë në përputhje me Bilancet duhet theksuar se rritja e prodhimit të energjisë termike nuk korrespondon me rritjen e sipërfaqeve ngrohëse. Në fakt ju keni planifikuar një rritje të prodhimit të energjisë prej mesatarisht 14% nga realizimet e sezonit 2023/'24, ndërsa rritja e sipërfaqes ngrohëse është vetëm 1.6% (më gjerësisht në komentin për sipërfaqet ngrohëse).

**Përgjigje nga Termokos :**

- Sqarimin për këtë pikë do ta japim pas pranimit të raporteve nga "Enerco".

- Gjatë analizimit të kostos së planifikuar të personelit është vërejtur rritje e dukshme e kësaj kostoje në raport me realizimet e sezonit të kaluar 2023/'24. Konkretisht, për koston e personelit të angazhuar drejtpërdrejt në prodhim dhe shpërndarje ('puna direkte') është paraqitur vlera prej 1,649,370 € që paraqet një rritje prej 10%, ndërsa për koston e personelit në administratë dhe shërbimet tjera është paraqitur vlera e planifikuar prej 1,885,288 €, që gjithashtu paraqet një rritje prej rreth 10% nga vlera e realizuar në sezonin e kaluar 2023/'24. Nëse i referohemi kostos totale të personelit, po ashtu vërehet një diferencë e konsiderueshme në mes të vlerës së kësaj kostoje në Pasqyrat Rregullative të planifikuara (totali i kostos së personelit: 3,534,658 €) dhe në Pasqyrat financiare statutore për vitin kalendarik 2023 (2,931,418 €); pra është një rritje prej mbi 600,000 € ose rreth 20%. Nevojitet të ofroni detaje për llogaritjen e kësaj kostoje duke dhënë numrin e punëtorëve, pagën mesatare dhe elemente tjera të kostos së personelit, si p.sh. kontributet / taksat etj. Po ashtu duhet dhënë arsyetimet përkatëse për rritjen e parashikuar.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Numri i punëtorëve në listën e pagave duke përfshirë edhe Bordin e Drejtorëve si dhe Aksionarët është 251 punëtorë.

Paga mesatare sipas kontratës bazë del të jetë 834 euro duke mos përfshirë shujtat, përvojën e punës si dhe stimulimet tjera.

Në totalin e kostove të personelit janë përfshirë edhe kontributet pensionale, tatimet në paga, shujtat ditore, përvoja e punës, rritje prej 10% të pagave si dhe stimulime për disa festa zyrtare gjatë vitit. Rritja e pagave prej 10% është planifikuar duke pasur parasysh inflacionin në vend, pasiqë në vitin aktual 2024, vërehet qartë se çmimet e produkteve bazë në një periudhë shumë të shkurtë kohore janë ngritur shumë.

- Për koston e energjisë elektrike ju keni paraqitur shumën prej 885,000 € që përbëhet nga shpenzimet e energjisë elektrike në prodhim (619,591€) dhe për nënstacionet termike (265,409 €); lidhur me këtë, duhet theksuar se është parashikuar një rritje e konsiderueshme prej afërsisht 20% krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në sezonin e kaluar 2023/'24 (743,538€). Është e kuptueshme se me zgjerimin e bazës së konsumatorëve gjegjësisht rritjen e sipërfaqeve ngrohëse, rritet shpenzimi i energjisë elektrike e sidomos për shkak të rritjes së numrit të nënstacioneve termike, mirëpo kjo rritje duhet të shpjegohet me detajisht dhe të argumentohet mirë.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Planifikimin e kostos së energjisë elektrike për periudhën kohore 2024/25 e kemi kalkuluar me TVSH dhe ngritja nga planifikimi i vitit të kaluar e cila është shumë e përafërt me shpenzimin e bërë është 6%. Ndërsa shuma e shpenzimit prej 743,538€ të potencuar nga anaj juaj është pa TVSH.

Ngritja e planifikimit prej 6%, është bërë me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të energjisë elektrike bazuar në rritjen e numrit të nënstacioneve në distribuim, e që rrjedhimisht do të ketë edhe shpenzim me të lartë të energjisë elektrike. Në Shpalosjen e Pasqyrës B është bërë përmirësimi dhe është vendosur vlera e kostos për energji elektrike pa TVSH.

Për pozicionet e kostove: 'Mirëmbajtja dhe riparimet' dhe 'Materialet dhe shërbimet' ju keni paraqitur parashikimet prej 130,435 € respektivisht 160,000 €, ku në shpalosjen e pasqyrës 'B' keni dhënë mjaft të detajuar nën-komponentët e këtyre pozicioneve. Nga detajizimi i dhënë vërehet se shuma e komponentëve të kostos ' materialet dhe shërbimet është 100,000 €, ndërsa në Pasqyrën 'B' ju keni paraqitur vlerën 160,000 € - duhet të përmirësoni këtë vlerë. Megjithatë duhet përmendur se këto vlera të planifikuara ndryshojnë dukshëm nga realizimet e sezonit të kaluar 2023/2024; sidomos rritje e madhe prej mbi 50% vërehet te pozicioni 'Mirëmbajtja dhe riparimet' krahasuar me realizimin në sezonin 2023/'24 (85,369€). Nevojitet shpjegim adekuat për këto ndryshime të këtyre kostove të planifikuara.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Janë bërë përmirësimet në Pasqyrën B dhe Shpalosjen e Pasqyrës B, dhe disa vlera janë korrigjuar. Mirëpo, bazuar në zgjerimin e rrjetit të distribuimit pas realizimit të projekteve zhvillimore viteve të fundit, rrjedhimisht do të paraqiten edhe kërkesa shtesë për mirëmbajtjen e rrjetit dhe nënstacioneve.

- Nën pozicionin "Shpenzimet e shitjes dhe tjera administrative" është paraqitur vlera prej 776,910 €, që paraqet një rritje të shumëfishtë krahasuar me realizimet e sezonit 2023/'24 (160,370 €). Nga detajizimi vërehet se në këtë pozicion keni përfshirë edhe komponentët: blerja e kompjuterëve dhe

licencave për programet kompjuterike në vlerë totale 80,000 €; lidhur me këtë duhet të sqarojmë se këto dy komponentë i përkasin investimeve dhe nuk duhet të përfshihen në këtë pozicion. Gjithashtu nga detajizimet vërehet se keni përfshirë edhe komponentën: "shpenzimet e tatimit në fitim' në vlerën 214,000€; edhe për këtë komponentë duhet t'ju sqarojmë se, sipas metodologjisë tarifore, 'shpenzimet e tatimit në fitim' trajtohet dhe përfshihet në Kthimin në asete, ku përmes WACC-ut dhe vlerës së RAB (shiko Raportin e ZRRE-së për të hyrat e lejuara) përcaktohet Kthimin në asete, kështu që kjo kosto nuk i përket kostove operative. Ju lutem të konfirmoni gjetjet tona më lartë.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Ne i kemi bërë ndryshimet e nevojshme në shpalosjen e Pasyrës A dhe B.

c) Pasqyra 'C' e Faturimit dhe Arkëtimit – të dhënat e parashikuara për sipërfaqen e ngrohjes, faturimin dhe arkëtimin

o Fillimisht duhet theksuar se në Pasqyrën 'C' vlera totale e faturimit të parashikuar prej 10,080,698 €, përputhet plotësisht me vlerën e të hyrave nga shitja e ngrohjes e paraqitur në Pasqyrën 'B'. Shuma e paraqitur e faturimit përbëhet nga faturimi me matje në vlerë prej 2,785,70 € dhe faturimit pa matje (sipas sipërfaqes ngrohëse) në vlerë 7,294,978 €. Vërehet se pjesëmarrja në faturimin total (si përqindje) është afërsisht e njëjtë me realizimet e sezonit të kaluar 2023/'24. Më konkretisht, vërehet se faturimi me matje është afërsisht i njëjtë me realizimin e sezonit të kaluar, përderisa ka një rritje në faturimin pa matje.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Sqarimin për këtë pikë do ta japim pas pranimit të raporteve nga "Enerco".

o Në ndërlidhje me përqindjen e faturimit me matje vërejtja kryesore ka të bëj me mos-planifikimin e faturimit me matje për ndërtesat kolektive, ku në kuadër të projektit të MCC-'Prishtina Heat Save' janë instaluar nëpër apartamente HCA-të dhe matësit individual të energjisë termike. Pra planifikimet e juaja në këtë Pasqyrë nuk kanë marrë parasysh kalimin nga faturimi sipas sipërfaqes ngrohëse në faturimin e bazuar në matjen e konsumit të ngrohjes. Përderisa, në takimet e rregullta për këtë qështje, NQ Termokos ka konfirmuar se, me përfundimin e instalimit të gjithë matësve dhe implementimin e softverit për leximin dhe faturimin e bazuar në matje, sipas metodologjisë së aprovuar nga ZRRE, do të filloj faturimin e bazuar në matje në sezonën 2024/'25. Nëse NQ Termokos ende planifikon të filloj faturimin me matje në këto ndërtesa kolektive, duhet të korrigjoj planifikimet në këtë pasqyrë; gjithashtu planifikimet duhen të shoqërohen me të dhëna dhe informata përcjellëse për: numrin e konsumatorëve të cilët planifikohen të faturohen me matje, sipërfaqet ngrohëse respektive, kapacitetin termik, konsumin e parashikuar të përllogaritur bazuar në regjistrimet e matjeve në sezonin e kaluar etj.; këto të dhëna dhe informata duhet të jenë të përmbledhura dhe të strukturuara sipas nënstacioneve / ndërtesave, rajoneve të distribuimit. Lidhur me regjistrimet e matjeve në ndërtesat kolektive duhet theksuar se, në kuadër të raportimit të realizimeve për sezonin e kaluar, ju keni dorëzuar (me vonesë) matjet e regjistruara në ndërtesat ku janë instaluar matësit, porse këto regjistrime nuk janë të plota – nuk përfshijnë gjithë sezonin 23/24 (vetëm muajt janar – prill 2024), si dhe nuk janë përfshirë të gjithë konsumatorët e këtyre ndërtesave. Gjithashtu duhet theksuar se këto të dhëna nuk janë të përmbledhura dhe të strukturuara ashtu që të mundësojnë një analizë të mirëfilltë të nevojshme për shqyrtimin tarifor.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Sqarimin për këtë pikë do ta japim pas pranimit të raporteve nga "Enerco".

Nga analiza e jonë është vërejtur se, sipërfaqja e përgjithshme e ngrohjes është planifikuar të rritet për 34,401 $m^2$ nga sezoni i kaluar. Në shtesë ju keni dhënë . në mënyrë mjaft detale planifikimet e kyçjeve të reja, që në total arrijnë të njëjtën rritje të sipërfaqes. Lidhur me kyçjet e reja respektivisht rritjen e sipërfaqes ngrohëse, duhet theksuar se planifikimet e juaja reflektojnë kyçjet e reja të objekteve si rrjedhojë e dendësimit dhe zgjerimit të rrjetit në kuadër të projektit të KfW që është në përfundim e sipër. Sipas informacionit të ofruar nga ju në kuadër të monitorimit të këtij projekti numri i ndërtesave të kyçura në rrjet dhe sipërfaqet ngrohëse respektive janë dukshëm më të mëdha. Ne kemi parasysh se jo të gjithë konsumatorët e ndërtesave të kyçura automatikisht regjistrohen si konsumatorë dhe do të shfrytëzojnë realisht ngrohjen në sezonin 2024/'25. Megjithatë ju udhëzojmë të analizoni sa më objektivisht mundësinë e kontraktimit me konsumatorët banues të atyre objekteve në mënyrë që të jeni më real në planifikimet e sipërfaqeve ngrohëse. Krahas analizës së planifikimit të sipërfaqeve ngrohëse nevojitet edhe një arsyetim për këto planifikime të sipërfaqes ngrohëse sidomos për raportin mes sipërfaqes së objekteve të kyçura dhe rritjes së planifikuar të sipërfaqes ngrohëse.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Sqarimin për këtë pikë do ta japim pas pranimit të raporteve nga "Enerco".

d) Pasqyra 'D' e shpenzimeve investive – investimet kapitale të planifikuara

- Investimet e planifikuara të paraqitura nga ju janë shoqëruar me shpjegimet përkatëse për mënyrën e financimit – d.m.th. me vetë-financim dhe nga donacionet, si dhe detajimet e komponentëve të projekteve. Vërehet se pjesa dërmuese e investimeve planifikohet të financohet nga donacionet e organizatave / institucioneve ndërkombëtare (Qeveria Gjermane përmes KfW, BE-Banka Evropiane për Investime) me një pjesëmarrje të vetëfinancimit nga ndërmarrja. Shpjegimet shoqëruese gjithashtu përmbajnë detaje tjera të projekteve investive të paraqitura dhe janë paraqitur vlerat që planifikohen për periudhën njëvjeçare që përfshinë shqyrtimi tarifor, si dhe gjendjen gjegjësisht fazat aktuale përgatitore të këtyre projekteve. Duhet theksuar se projektet e planifikuara për këtë sezonë vijuese janë të përfshira edhe në draft planin e azhurnuar zhvillimor afatgjatë, i cili ende nuk është aprovuar nga ZRRE për shkak të disa mangësive.
- Lidhur me Projektin e MCC për instalimin matësve të ngrohjes duhet theksuar se është paraqitur vlera e mbetur e realizimit të projektit prej 926,973 €, në të cilën përfshihen edhe shërbimet e konsulencës. Gjithashtu vërehet se ka pasur shtesa të vlerave monetare të investimit si në blerjen dhe instalimin e matësve dhe pajisjeve tjera ashtu edhe për shërbimet e konsulencës. Për këtë duhet rikujtuar se në shqyrtimet e kaluara ZRRE ka lejuar investimet në pajisjet matëse të energjisë termike në nivel apartamenti sipas kontratës fillestare dhe se shuma e lejuar është raportuar e realizuar. Ndërsa në shqyrtimin e sezonit të kaluar 2023/'24 ZRRE ka lejuar vetëm investimet për instalimin e grupimit të pajisjeve të nënstacioneve termike në vlerë 663,607 €, duke marrë parasysh ndikimin në operim efiçient të sistemit dhe në kursimin e energjisë termike. Nisur nga fakti se në detajizimet e juaja vërehet se sasitë e pajisjeve matëse mbesin të njëjta dhe nuk keni dhëni arsyetimet përkatëse për shtesat monetare të projektit, e gjithashtu mbetet e paqartë nëse ky investim do të jetë në kuadër të kontratës aktuale për blerjen dhe instalimin e matësve të ngrohjes. Prandaj ZRRE nuk do ta merr parasysh investimin e propozuar pa u ofruar këto sqarime dhe pa u paraqitur një projekt-propozim detal për pajisjet dhe

ndërtesat ku do të instalohen këto pajisje si dhe vlerat përkatëse që parashihen të bashkëfinancohen në kuadër të këtij projekti.

**Përgjigje nga Termokos :**

Sqarimet për shtesat e projektit të MCC :

a) Sa i përket shtesës së vlerave monetare të investimit si në blerjen dhe instalimin e matësve dhe pajisjeve tjera poashtu edhe për shërbimet e konsulencës, këto shtesa janë aprovuar në bazë të Amandamentit Nr.6 (Referencë:BD/QPBS/2021) të marrëveshjes së kontraktuar për prokurimin e mallërave dhe shërbimeve përkatëse të datës 06.12.2023 (për kontraktorin) dhe Amandamentit Nr.4 (Referencë:RFP/MFK/20219/QSBS/N$_0$.026) për Marrëveshjen me konsulencë për mbikqyrjen e kontrollit të cilësisë për zbatimin e DMH, të datës 15.12.2023, me këto kushte :

1. Të ruhen çmimet e kontratës paraprake ,
2. Ngritja e çmimit të kontratës t'i përmbahet buxhetit të alokuar për projektin "Prishtina Heat Save".

b) Kërkesa për pajisje shtesë ka ardhur si rezultat i kërkesës së kontraktorit për plotësimin e numrit të konsumatorëve për 17 500 konsuamtorë ( për konsumatorët tek të cilët nuk kanë pasur çasje në lagjet tjera, të zëvendsohen /plotësohen më konsumatorët në lagjen Mati 1). Gjatë survejimit është vërejtur se në lagjen "Mati 1" sistemi i ngrohjes qëndrore është sistem horizontal, sipas të cilit është nevojitur instalimi i valvolave trekahore, të cilat nuk kanë qenë të parapara në kontratën bazë.

c) Pajisjet shtesë janë bërë në bazë të survejimit emergjent për shkak të porosisë së shpejtë dhe janë paraparë për lagjen Mati 1, dhe për këtë nuk ekziston survejim (një projekt-propozim ) i detajizuar.

Meqenëse projekti i MCC përfundon në janar të vitit 2025, nga fonet e NP"Termokos"Sh.a si bashkëfinancues i këtij projekti duhet të ekzekutohet shuma e paraqitur në raport prej 926,972.57 euro. Në tabelat në vijim (tab. 1,2,3) janë paraqitur sasia dhe vlerat monetare për pajisjet shtesë.

| **Tabela 1:** | **SHTESAT PËR PAJISJET E PROJEKTIT TË MCC-DERI ME 31.01.2025** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Astetet/Euro | Materiali instalues /Euro | Punët për instalim/Euro | Total /Euro |
| Valvola termostatike trekahore | 257 631.00 | 13 368,96 | 370 919,01 | 641 918,97 |
| Pajisjet për mbledhjen e të dhënave (Data collection) | 105 656,02 | 74 239,17 | 17794,41 | 197 689,60 |
| Totali i shtesave sipas "Amandamentit Nr.6 "(BOQ e re për Pajisjet për mbledhjen e të dhënave (Data collection) dhe Valvola termostatike trekahore) | **363 287,02** | **87 608,13** | **388 713,42** | **839 608,57** |

| Tabela 2: | SHTESAT PËR KONSULENCËN E PROJEKTIT TË MCC-DERI ME 31.01.2025 | |
|---|---|---|
| | PERIUDHA | VLERA /Euro |
| Raportet mujore (12) | Shkurt 2024-Janar 2025 | 240,000.00 |
| Kampanja e vetëdijësimit, marketingu | Shkurt 2024-Janar 2026 | DERI 150,000,00 |
| Totali I shtesave sipas "Amandamentit Nr.4 ": **390,000,00 Euro** | | |

| Tabela 3: | SASIA E PAJISJEVE SHTESË | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Valvola termostatike trekahore të radiatorit | | Data Collection/Transmission gateway | |
| | Sasia /copë | Çmimi /€ | Sasia /copë | Çmimi /€ |
| BOQ 1,2 (MFK) | 2 000 | 74 000,00 | 2 871 | 635 606,62 |
| BOQ e re (për 3500 apartamente në Mati 1) | 6 963 | 257 631,00 | 391 | 197 689,60 |
| Total : | **8 963** | **331 631,00** | **3 262** | **833 296** |

- Për projektin aktual të KfW: Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacione të reja, duhet theksuar se ky projekt që ka filluar të realizohet para 3 viteve ka pasur shtesa të konsiderueshme nga vlera fillestare e parashikuar e projektit. Duke qenë se shtesat e fundit nuk janë arsyetuar në Plan Zhvillimor, gjegjësisht nuk janë paraqitur për azhurnim të planit, në shqyrtimin e kaluar tarifor 2023/2024, ZRRE nuk ka pranuar shtesat dhe ka lejuar shumën e mbetur nga vlera fillestare e planifikuar; në monitorimin e realizimeve është konstatuar se kjo shumë e lejuar është tejkaluar. Rrjedhimisht vlerësohet se investimet e lejuara në kuadër të këtij projekti janë realizuar, kështu që vlerat e paraqitura në këtë shqyrtim tarifor konsiderohen si tejkalime (shtesa) të projektit për të cilat kërkohen shpjegime, detajime dhe dokumente përkatëse për të dëshmuar arsyeshmërinë teknike dhe financiare të këtyre shtesave të investimit, e sidomos analizat e kosto-përfitimit. Lidhur me këtë duhet rikujtuar se këto kërkesa nuk janë adresuar në Planin e azhurnuar zhvillimorë.

**Përgjigje nga Termokos:**

- Të gjitha ndryshimet dhe tejkalimet e bëra për projektin aktual të KfW- Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacione të reja, janë paraqitur në "Raportin e progresit nr. 19" të cilin ua dërgojmë të bashkangjitur në e-mail dhe sqarimet për ndryshimet e bëra për tenderin T1 dhe T2 i gjeni në këtë dokument; në Tabelën 3 faqe 4 - shtesat për tenderin T1, ndërsa shtesat për tenderin T2 të cilat edhe e bëjnë diferencën, janë paraqitur në tabelën 4 faqe 13.

Në këto tabela në kolonën e fundit janë dhënë edhe arsyetimet në formë të shkurtë për shtesat e projektit .

Arsyetimet për këto shtesa të projektit më gjerësisht janë paraqitur në Minutat e Takimeve të bashkangjitura me këtë raport:

1. **Shtesa për Variation Order nr. 1** -sqarohen në " Minutat e takimit M2" të datës 10.03.2022 në pikën 13.2 (dokument i bashkangjitur).

2. **Shtesa për Clame 1 dhe 2**- sqarohen në "Minutat e takimit M14" të datës 08.04.2022 në pikën 12 (dokument i bashkangjitur).

3. **Shtesa për Variation Order nr.3** (vlera 45 846.2 euro) - është për ndryshimin e diametrit të gypit furnizues nga DN400 në DN450 për segmentin nga ish "Hotel Baci" deri te Ngrohtorja e Spitalit.

4. **Shtesa për Variation Order nr.4** - sqarohen në "Minutat e takimit M15 "të datës 10.05.2022 në pikën 4 – Arbëria (dokument i bashkangjitur).

Ndërsa, **Kost Benefit Analizë** për këtë projekt Termokosi nuk posedon.

Andaj, megenëse punimet për realizimin e Projektit aktual të KfW për "Rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve të reja" kanë përfunduar, shuma e planifikuar prej 1,680,460.11euro duhet të paguhet brenda periudhës raportuese nga fondi i Termokosit si bashkëfinancues i projektit.

Sa i përket 2 projekteve tjera të paraqitura: Projekti i KfW-EU-EBRD Solar4Kosova dhe Projekti i EU-EIB për dyfishimin e kapacitetit të kogjenerimit, duhet marr parasysh vonesat që kanë ndodhur në të kaluarën në realizimin e këtyre projekteve – konkretisht nga monitorimi i realizimit të investimeve në sezonin e kaluar 2023/'24 është konstatuar se këto projekte nuk kanë filluar të realizohen. Prandaj me qëllim të përcaktimit sa më të saktë të Bazës së Rregulluar të Aseteve, nevojitet një qasje sa më realiste në planifikimin e realizimit të këtyre projekteve.

**Përgjigje nga Termokos:**

- Sa i përket projektit "Solar 4 Kosova" është bërë revidim të vlerave dhe përmirësimet janë paraqitur në "Pasqyrën D".

- Sa i përket investimeve me vetë-financim keni parashikuar një vlerë mjaft të madhe prej 5,571,314 €, ku në këtë vlerë pozicionet kryesore janë vlera e bashkëfinancimit të projekteve të donatorëve prej 2,607,433€ (projektet e MCC dhe KfW) dhe ndërtesa e administratës në vlerë 1,842,881 €. Në vlerën e mbetur prej 991,000€ përfshihen investimet në pajisjet e prodhimit (471,000 €), në rrjetin e shpërndarjes (520,000 €) dhe në pajisjet dhe programet e teknologjisë informative në vlerë 80,000€.

**Përgjigje nga Termokos:**

- Investimet kapitale të planifikuara për pajisjet e prodhimit për vitin kalendarik 2025, jemi bazuar mbi nevojën dhe kërkesën për investim në pajisjet e prodhimit të cilat janë të domosdoshme që të realizohen dhe konsiderojmë se vlerat e paraqitura janë të arsyeshme bazuar në vlerën e tregut.
- Për investimeve kapitale të planifikuara në departamentin e Distribuimit, jemi bazuar në planin aksional për zgjerim të rrjetit në kuadër të dendsifikimit të rrjetit për kyçjen e konsumatorëve të ri , e që nënkupton investim në rrjetin shpërndarës, nënstacione, ndërtim të pusetave, rregullimin e hapësirave të dëmtuara, etj.
- Ndërsa sa u përket investimeve në pajisjet dhe programet e teknologjisë informative në vlerë 80,000€, u sqarojmë se:

Termokosi aktualisht nuk ka asnjë produkt të teknologjisë informative të licencuar, prandaj kemi planifikuar licencimin dhe përditësimin e pajisjeve të teknologjisë informative. Bazuar në vlerën e tregut, ne kemi planifikuar shumën prej 60 000.00 euro për blerjen e licenceve të Sistemit Operativ dhe Microsoft Office për të gjithë përdoruesit e PC. Aktualisht Termokosi posedon rreth 100 kompjuter, rreth 50 printer, 10 llaptop duke përfshirë edhe 11 nënstacione që janë në zgjerim e sipër, ku secili nënstacion ka pajisjet

(kompjuter dhe printer) të kyçura në rrjet. Gjithashtu jemi në pritje të bartjes së infrastrukturës në objektin e ri, gjë që ka ndikuar në rritjen e kostos. Andaj konstatojmë që vlera e planifikuar prej 60 000.00 euro për këtë qëllim është mëse reale.
Ndërsa për furnizimin me kompjuterë, laptop, printera dhe ploter , kemi planifikuar shumën prej 20 000.00 euro duke u bazuar në rritjen e numrit të personelit krahas zgjerimit të rrjetit të ngrohjes, dhe konsiderojmë që vlera e parashikuar është e arsyeshme duke pasur parasysh ngritjen e çmimeve në treg për pajisjet e teknologjisë informative.

Lidhur me bashkëfinancimin e projekteve të donatorëve referohuni në komentet më poshtë për secilin nga projektet e donatorëve. Për sa i përket investimeve tjera me vetëfinancim duhet theksuar se në monitorimin e realizimeve të periudhës (sezonit) të kaluar është konstatuar se **investimet** me vetë-financim janë realizuar në nivelin 68%. Ndërsa konkretisht për investimin e lejuar prej 482,000 € për ndërtimin e objektit të administratës, është realizuar në vlerën 590,872€ pra një mbi-realizim prej 22%. Për çka u tha më lartë duhet që planifikimet të jenë reale dhe të arsyetuara, e njëjta vlen edhe për shtesat (rritjet e vlerave të investimeve) që duhet arsyetuar / argumentuar mjaftueshëm, ashtu që këto planifikime të pranohen në shqyrtimin tarifor.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Pjesa financiare sipas kontratës për ndërtimin e objektit pritet të përfundoj në muajin shkurt 2025. Sipas buxhetit vlera e shpenzuar për këtë projekt në vitin 2023 ishte 590,872 euro, ku sipas kontratës vlera tjetër e planit të buxhetit për vitin 2024 dhe Janar-Shkurt 2025 pritet të ekzekutohet shuma prej 1,842,881.34euro për t'a përmbyllur kontratën. Në vlerën e planifikuar për mbikqyrje të ndërtimit të objektit, ne këmi bërë revidim të vlerës dhe ndryshimin e kemi paraqitur në "Pasqyrë D".

e) Pasqyra teknike 'E' –të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve.

Nga analiza e kësaj pasqyre është vërejtur paraqitje e saktë e të dhënave dhe në përputhje dhe të dhënat përkatëse të dokumenteve dhe shpjegimeve mbështetëse; nuk ka ndonjë koment për këtë pasqyrë.

2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutore për vitin 2023

Pasqyrat financiare statutore për vitin 2023: "Pasqyra e pozitës financiare", "Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse", "Pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet", janë të përfshira në Raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe të aprovuara nga menaxhmenti i ndërmarrjes dhe të nënshkruara nga zyrtarët kompetentë. Nuk ka ndonjë koment tjetër shtesë.

3) Dokumentet tjera mbështetëse:

3.1 Planifikimet e sipërfaqeve ngrohëse dhe kyçjeve të reja për sezonin 2024/2025

- Janë paraqitur të dhëna mjaft detaje në formë tabelare për planifikimet e kyçjeve të reja që përmbajnë të dhënat për vendndodhjen (lokacionin) e objekteve, numrin e banesave dhe njësive afariste dhe sipërfaqet ngrohëse përkatëse. Sipas përshkrimit tabelarë vërehet se

sipërfaqja totale e objekteve - kyçjeve të reja të planifikuara është 34,401m$^2$. Lidhur me këtë duhet theksuar se ky planifikim reflekton dendësimin dhe zgjerimin e rrjetit sipas dinamikës së realizimit të projektit të KfW që është në përfundim e sipër. Sipas informacionit të ofruar nga ju në kuadër të monitorimit të këtij projekti numri i ndërtesave të kyçura në rrjet dhe sipërfaqet ngrohëse respektive janë dukshëm më të mëdha. Ne kemi parasysh se jo të gjithë konsumatorët e ndërtesave të kyçura automatikisht regjistrohen si konsumatorë dhe do të shfrytëzojnë realisht ngrohjen në sezonin 2024/'25. Lidhur me këtë ju udhëzojmë të analizoni sa më objektivisht mundësinë e kontraktimit me konsumatorët banues të atyre objekteve në mënyrë që të jeni më real në planifikimet e sipërfaqeve ngrohëse. Krahas analizës së planifikimit të sipërfaqeve ngrohëse nevojitet edhe një arsyetim për këto planifikime të sipërfaqes ngrohëse sidomos për raportin mes sipërfaqes së objekteve të kyçura dhe rritjes së planifikuar të sipërfaqes ngrohëse.

**Përgjigje nga Termokos :**

- Sqarimin për këtë pikë do ta japim pas pranimit të raporteve nga "Enerco".

3.2) Planifikimi i prodhimit të energjisë termike, furnizimit dhe humbjeve në rrjet

- Prodhimi i energjisë termike është parashikuar të jetë kryesisht nga stabilimentet e kogjenerimit në TC Kosova B, ku detajet janë paraqitur në formë tabelare për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi bazuar në Bilancin e energjisë dhe në planifikimet përkatëse për pjesën e dytë të sezonin (janar – prill 2024).
- Sa i përket vlerësimeve për furnizimin dhe humbjet në rrjet, duhet pasur parasysh dhe duhet bazuar në planifikimet përkatëse në Bilancet vjetore dhe afatgjata të energjisë termike.

**Përgjigje nga Termokos**

- Në përputhje me Bilancin afatgjatë të energjisë termike janë bërë përmirësimet për nivelin e planifikuar të humbjeve në rrjet, dhe përmirësimet e bëra janë paraqitur në tabelat përatëse.

Shënim:

Këto komente janë dhënë me qëllim të korrigjimit dhe kompletimit të aplikacionit për tarifa në përputhje me kërkesat specifike të paraqitura aty.

Përgatitur nga:

Departamenti i Energjisë Termike dhe Gazit (DETG)

# Raportimi Rregullativ - Shqyrtimi i tarifave për sezonin 2024/2025

ɪrmarrja NP" Termokos "sh.a  Periudha: 15.10.2024-15.10.2025

***Pasqyra B - G1, G2 : Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve***

| | | VITI 2024 | VITI 2025 | Total |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Të Ardhurat e lejuara** | (tetor - dhjetor) 2024 | (janar - tetor) 2025 | Tetor 2024- tetor 2025 |
| 2 | Të ardhurat nga shitja e ngrohjes | **4 233 893,28** | **5 846 805,01** | **10 080 698,29** |
| 41100 | Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Sek.Banesor | 2 583 241,04 | 3 567 332,86 | 6 150 573,90 |
| 41110 | Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Sektori Afarist | 480 649,76 | 663 754,44 | 1 144 404,20 |
| 41120 | Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Institucional | 1 170 002,48 | 1 615 717,71 | 2 785 720,19 |
| 3 | Të ardhurat tjera të lejuara | **46 000,00** | **59 000,00** | **105 000,00** |
| 41140 | Të ardhurat nga kyqjet (ç'kyqjet) e ngrohjes | 10 000,00 | 10 000,00 | 20 000,00 |
| 41150 | Të hyrat nga shtija e mbeturinave | 0,00 | 1 000,00 | 1 000,00 |
| 45000 | Të ardhurat nga shërbimet tjera | 15 000,00 | 15 000,00 | 30 000,00 |
| 45100 | Të hyrat nga taksat gjyqësore-taksat për administrimin e lëndëve përmbarimore | 6 000,00 | 18 000,00 | 24 000,00 |
| 41130 | Të ardhurat nga rrjeti sekondar | 10 000,00 | 10 000,00 | 20 000,00 |
| 43100 | Zbritjet e lejuara nga faturimi | 5 000,00 | 5 000,00 | 10 000,00 |
| 4 | **Totali i të ardhurave të lejuara** | **4 279 893,28** | **5 905 805,01** | **10 185 698,29** |
| 5 | **Shpenzimet e lejuara** | | | |
| 6 | Shpenzimet Operacionale | | | |
| 7 | Nga kjo: Shpenzimet variabile | | | |
| 8 | këtu hyjnë: Karburanti | **705 996,00** | **1 038 356,40** | **1 744 352,40** |
| 50300 | Energjia termike nga ko-gjenerimi | 690 755,10 | 1 015 940,60 | 1 706 695,70 |
| 50001 | Nafta per prodhim | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 50000 | Mazuti per prodhim | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 60500 | Shpenzimet per raport te analizave te mazutit | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 79200 | Shpenzimet për licencë për shpërndarje të ngrohjes | 15 240,90 | 22 415,80 | 37 656,70 |
| 9 | Uji | **42 000,00** | **22 000,00** | **64 000,00** |
| 50100 | Shpenzimet e ujit | 42 000,00 | 22 000,00 | 64 000,00 |
| 10 | Kemikalet për trajtimin e ujit | **19 730,50** | **19 730,00** | **39 460,50** |
| | Kemikalet | 19 730,50 | 19 730,00 | 39 460,50 |
| 3E+05 | Elektriciteti | **290 600,40** | **523 599,60** | **814 200,00** |
| 50200 | Shpenzimet e energjisë elektrike (Prodhim) | 203 320,00 | 366 703,72 | 570 023,72 |
| 50201 | Shpenzimet e energjisë elektrike (Nënstacione) | 87 280,40 | 156 895,88 | 244 176,28 |
| 12 | Shpenzimet e Personelit (puna direkte ne prodhim) | **1 013 810,03** | **635 559,83** | **1 649 369,86** |
| 71200 | Prodhimi | 258 424,30 | 163 697,73 | 422 122,03 |
| 71200 | Distribuimi | 707 109,06 | 441 597,34 | 1 148 706,41 |
| 71201 | Kontributet për kontribute pensionale (Pundhënësi) | 48 276,67 | 30 264,75 | 78 541,42 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13 | Shpenzimet tjera variabile | **930 216,50** | **0,00** | **930 216,50** |
| 66000 | Shpenzimet e interesit të kredisë | 143 716,50 | | 143 716,50 |
| 79900 | **Shpezimet e provizionimeve te L/A** | 786 500,00 | | 786 500,00 |
| 14 | **Totali I shpenzimeve variabile** | **3 002 353,43** | **2 239 245,83** | **5 241 599,26** |
| 15 | Shpenzimet fikse | | | |
| 16 | këtu hyjnë: Riparimet dhe mirëmbajtja | **45 275,00** | **62 875,00** | **108 150,00** |
| 70500 | Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve | 1 000,00 | 2 000,00 | 3 000,00 |
| 70300 | Shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve | 2 500,00 | 5 000,00 | 7 500,00 |
| 70200 | Shpenzimet për mirëmbajtjen e kompjut. dhe pajisjeve tjera | | 3 500,00 | 3 500,00 |
| 70400 | Shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve | 3 500,00 | 5 000,00 | 8 500,00 |
| 70700 | Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike | 2 000,00 | 0,00 | 2 000,00 |
| 70800 | Shpenzimet për mirëmbajtjen e programeve softverike | | 6 000,00 | 6 000,00 |
| 61500 | Shpenzimet e sigurimeve të objektit | 0,00 | 6 000,00 | 6 000,00 |
| 60301 | Shpenzimet e sigurimit të automjeteve | 1 000,00 | 3 000,00 | 4 000,00 |
| 60300 | Regjistrimi i automjeteve | 5 600,00 | 2 400,00 | 8 000,00 |
| 60302 | Shpenzimet e kontrolles teknik | 525,00 | 225,00 | 750,00 |
| 60303 | Shpenzimet për taksat rrugore | 900,00 | 400,00 | 1 300,00 |
| 60800 | Shpenzimet e taksave komunale | 350,00 | 150,00 | 500,00 |
| 85 | Shpenzimet për punimin e pusetave | 7 000,00 | 12 500,00 | 19 500,00 |
| 76000 | Shpenzimet për mbrojtje kundër zjarrit | 3 500,00 | 1 500,00 | 5 000,00 |
| 60100 | Shpenzimet për rregullimin e rrugëve të dëmtuara | 12 000,00 | 15 000,00 | 27 000,00 |
| 70100 | Shpenzimet per servisimin e pompave | 200,00 | 200,00 | 400,00 |
| 62100 | Shpenzimet për bazhadrimin e valvolave | 5 000,00 | 0,00 | 5 000,00 |
| 70000 | Shpenzimet per mirembajtjen e flakeruesve | 200,00 | | 200,00 |
| 17 | Materialet dhe shërbimet | **50 000,00** | **50 000,00** | **100 000,00** |
| 61200 | Shpenzimet materiale të mirëmbajtjes | 35 000,00 | 35 000,00 | 70 000,00 |
| 61250 | Shpenzimet e materialit elektrik | 5 000,00 | 10 000,00 | 15 000,00 |
| 61300 | Shpenzimet e materialit zyrtar | 10 000,00 | 5 000,00 | 15 000,00 |
| 18 | Shpenzimet për administratë | **57 140,00** | **92 460,00** | **149 600,00** |
| 74100 | Shpenzimet e udhëtimit zyrtar | 3 500,00 | 1 500,00 | 5 000,00 |
| 74200 | Shpenzimet per ekskurzion | 10 500,00 | 4 500,00 | 15 000,00 |
| 75200 | Shpenzimet e byfesë | 4 620,00 | 1 980,00 | 6 600,00 |
| 61330 | Shpenzimet për hixhienë | 300,00 | 700,00 | 1 000,00 |
| 75300 | Shpenzimet per larje te automjeteve | 450,00 | 1 050,00 | 1 500,00 |
| 78000 | Shpenzimet e derivateve | 6 000,00 | 10 500,00 | 16 500,00 |
| 74000 | Shpenzimet e reprezentacionit | 3 000,00 | 7 000,00 | 10 000,00 |
| 79100 | Shpenzimet për avokat | 350,00 | 3 650,00 | 4 000,00 |
| 79150 | Shpenzimet e permbarimit | 15 000,00 | 45 000,00 | 60 000,00 |
| 71002 | Shpenzimet për mbushje telefonike | 2 150,00 | 5 150,00 | 7 300,00 |
| 71001 | Shpenzimet e telefonisë mobile | 2 450,00 | 1 050,00 | 3 500,00 |
| 71000 | Shpenzimet e telefonisë fikse | 120,00 | 380,00 | 500,00 |
| 72000 | Shpenzimet e internetit | 1 700,00 | 6 000,00 | 7 700,00 |
| 72400 | Shpenzimet e qiras | 7 000,00 | 3 000,00 | 10 000,00 |
| 72500 | Shpenzimet për mirëmbajtjen e web faqes | | 1 000,00 | 1 000,00 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 19 | Shpenzimet e personelit | **1 185 009,08** | **700 278,61** | **1 885 287,69** |
| 71200 | Departamenti Administrativ | 339 791,13 | 209 784,25 | 549 575,38 |
| 71200 | Departamenti Financiar | 95 723,98 | 63 669,61 | 159 393,59 |
| 71200 | Pagat për Bordin e Drejtorve dhe Aksionaret | 71 896,96 | 43 636,00 | 115 532,96 |
| 71200 | Njësia per Projekte Zhvillimore PIU | 150 052,29 | 56 606,29 | 206 658,57 |
| 71200 | Departamenti i Prokurimit | 29 019,72 | 16 697,78 | 45 717,50 |
| 71200 | Zyra Mbështetëse | 79 928,19 | 52 294,23 | 132 222,42 |
| 71200 | Departamenti i Furnizimit | 302 348,22 | 175 692,42 | 478 040,64 |
| 71200 | Departamenti për Zhvillim dhe Instimet Kapitale | 15 608,03 | 11 926,50 | 27 534,53 |
| 71200 | ZYRA LIGJORE | 15 970,98 | 8 798,69 | 24 769,67 |
| 65000 | Shpenzimet për sigurimet shëndetësore | 28 582,40 | 30 815,40 | 59 397,80 |
| 71201 | Kontributet për kontribute pensionale (Pundhënësi) | 56 087,19 | 30 357,46 | 86 444,64 |
| 20 | Shpenzimet e Shitjes dhe tjera Administrative | **227 560,00** | **247 550,00** | **475 110,00** |
| 61600 | Shpenzimet e provizioneve bankare | 15 000,00 | 16 000,00 | 31 000,00 |
| 61701 | Shpenzimet e mbeturinave | 600,00 | 1 400,00 | 2 000,00 |
| 63100 | Shpenzimet për festa | 14 000,00 | 4 000,00 | 18 000,00 |
| 64000 | Shpenzimet per ndihma | 1 500,00 | 3 500,00 | 5 000,00 |
| 71203 | Shpenzimet e konsulencës | 150 000,00 | 160 000,00 | 310 000,00 |
| 71300 | Shpenzimet për tatimin në pronë | 2 800,00 | 1 200,00 | 4 000,00 |
| 73000 | Shpenzimet për taksa gjygjësore | 4 000,00 | 7 000,00 | 11 000,00 |
| 73500 | Shpenzimet për shpallje dhe njoftim | 600,00 | 1 200,00 | 1 800,00 |
| 63000 | Shpenzimet tjera | 5 000,00 | 10 000,00 | 15 000,00 |
| 61350 | Shpenzimet për rroba mbrojtëse | 10 500,00 | 24 000,00 | 34 500,00 |
| 61100 | Shpenzimet e ngritjes profesionale - trajnime | 14 000,00 | 6 000,00 | 20 000,00 |
| 75100 | Shpenzimet e promovimit te afarizmit | 9 560,00 | 13 250,00 | 22 810,00 |
| 21 | **Totali I shpenzimeve fikse** | 1 564 984,08 | 1 153 163,61 | 2 718 147,69 |
| 22 | Totali I shpenzimeve operative | | | |
| 23 | **Zhvlerësimi** | **2 148 500,00** | **1 140 350,00** | **3 288 850,00** |
| **24** | **Totali I Shpenzimeve të Lejuara** | **6 715 837,51** | **4 532 759,44** | **11 248 596,95** |